



Trusti

**RAPORTI
VJETOR
2022**

Trusti
Të gjitha të drejtat e rezervuara *
Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
Kosovski Penzijski Štedni Fond
Kosovo Pension Savings Trust

Botues

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës

Botuar

Maj 2023

Fotot

Të gjitha fotot e publikuara janë të realizuara në Kosovë

Të gjitha të drejtat e rezervuara®

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës
Kosovski Penzijski Štedni Fond
Kosovo Pension Savings Trust

TABELA E PËRMBAJTJES

0

4-15

Treguesit kryesorë
Misioni dhe ambicia
Parathënie

1

19-37

Organizata dhe
financat

2

39-47

Aktivitetet

3

49-59

Investimi i
kursimeve
pensionale

4

61-65

Kontribuimi dhe
pensionimet

5

67-79

Demografia
e kontribuuesve

6

81-83

Legjislacioni

7

Aneks

Raporti i auditorit të pavarur dhe
pasqyrat financiare - Operacionet

8

Aneks

Raporti i auditorit të pavarur
dhe pasqyrat financiare -
Mjetet Pensionale

PËRMBLEDHJE E TREGUESVE KRYESORË

PERFORMANCA E INVESTIMEVE PËR 10 VJETËT E FUNDIT (KUMULATIVE)

Periudha	1-vjeçare	2-vjeçare	3-vjeçare	4-vjeçare	5-vjeçare	6-vjeçare	7-vjeçare	8-vjeçare	9-vjeçare	10-vjeçare
Kthimi bruto nga investimet (në milionë)	€(119.9)	€107.4	€179.2	€339.9	€255.2	€357.7	€422.3	€451.9	€518.6	€589.7

INVESTIMET

PORTOFOLI STANDARD

	2022	2021
Çmimi i aksionit në fund të vitit	€1.6268	€1.7222
Ndryshimi i çmimit të aksionit gjatë vitit	-5.54%	+10.65%
Kthimi bruto nga investimet për vitin	-€121,477,711	€227,304,018
Interesat nga llogaritë bankare	-€122,815	-€170,401
Kthimet e tjera për vitin	--	€200,000
Provizionet	-€897,065	€986,336

PORTOFOLI KONSERVATIV

	2022	2021
Çmimi i aksionit në fund të vitit	€2.0588	--
Ndryshimi i çmimit të aksionit gjatë vitit	+2.94%	--
Kthimi bruto nga investimet për vitin	€2,728,766	--
Interesat nga llogaritë bankare	-€9,643	--
Provizionet	-€188,200	--

MNM (TË NJËSUARA)

	2022	2021
Portofoli Standard	€2,316,363,922	€2,353,174,912
Portofoli Konservativ	€94,812,043	--

KONTRIBUTET DHE KONTRIBUESIT

	2022	2021
Kontributet e arkëtuara për vitin	€241,462,429	€213,450,809
Kontributet e arkëtuara prej themelimit	€2,430,714,987	€2,189,252,434
Llogari të reja të hapura gjatë vitit	40,409	45,290
Numri i llogarimbajtësve në fund të vitit	792,995	752,586
Numri i kontribuuesve aktivë në fund të vitit	428,891	419,657

Të gjitha të dhënat dhe analizat e paraqitura në këtë Raport Vjetor, si p.sh.: mjetet neto ose bruto nën menaxhim, kontributet për vitin, ndryshimet në mjetet nën menaxhim; nuk i përfshijnë kontributet e arkëtueshme në vlerë €16.83 mln (2021: €13.77 mln).

PENSIONIMI

	2022	2021
Llogari me tërheqje kursimesh për vitin	6,907	7,239
Mjetet e tërhequra për vitin	€54,871,291	€52,855,024
Mjetet e tërhequra për 10%-shin*	--	€12,643,130
Llogari me tërheqje të plotë nga themelimi**	67,229	61,114
Mjetet e tërhequra prej themelimit	€558,800,880	€503,929,589

*Tërheqja e 10%-shit është mbyllur më 6 prill 2021, sikurse ishte përcaktuar në legjislacionin përkatës.

**Në këtë numër përfshihen pensionimet e moshës, rasteve të vdekjes dhe shtetasve të huaj. Ndërsa nuk përfshihen pensionimet e invaliditetit.

TARIFAT DHE SHPENZIMET

	2022	2021
Tarifa investuese	0.320%	0.320%
Tarifa operacionale	0.057%	0.065%
Tarifat e ngarkuara për vitin	€8,849,446	€8,492,038
Shpenzimet investuese për vitin	6,695,395	€6,840,347
Shpenzimet operacionale për vitin	1,139,768	€1,191,245

ALOKIMI I MJETEVE DHE SHËRBIMET

	2022	2021
Kontributet e paalokuara në fund të vitit	€2,950,426	€2,320,470
Kontributet e paalokuara në përqindje	0.121%	0.106%
Numri i llogarive në eTrusti	301,798	274,7187

SHPËRNDARJA E INVESTIMEVE MË 31.12.2022

Në **Portofolin Standard** mjetet pensionale investohen përmes fondeve të hapura që drejtohen nga menaxherët e këtyre fondeve në aksione, instrumente borxhi, para të gatshme dhe në instrumente të tjera financiare të korporatave botërore dhe të shteteve sovraane. Në fund të vitit FKPK-ja kishte investime direkte dhe indirekte në instrumente financiare të 1,988 emetuesve botërorë (2021: 2,099) në Portofolin Standard.

Në **Portofolin Konservativ** mjetet pensionale investohen drejtpërdrejt në fletobligacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes ankandave publike dhe në depozitat bankare në Kosovë. Në fund të vitit 2022 99% e investimeve të këtij portofoli ishin në fletobligacionet e Qeverisë së Kosovës; ndërsa pjesa tjetër e portofolit (prej 1%) ishte në depozita bankare në Kosovë.


10 PLASMANET KRYESORE NË NJË ENTITET TË VETËM E GJITHSEJ MJETEVE NËN MENAXHIM

Nr.	PLASMANI	ALOKIMI KUNDREJT GJITHSEJ MJETEVE	MJETET E FKPK (në milionë)
1.	Thesari i Kosovës	22.8%	€552.8
2.	Thesari i Francës	2.2%	€52.4
3.	BKT Banka Kosovë	1.6%	€39.7
4.	Thesari i Gjermanisë	1.5%	€35.5
5.	PCB Banka Kosovë	1.5%	€35.2
6.	Groupe BPCE	1.2%	€28.7
7.	Groupe Credit Mutuel	1.2%	€28.6
8.	NLB Banka Kosovë	1.1%	€27.2
9.	Barclays PLC	1.1%	€26.8
10.	BNP Paribas SA	1.1%	€25.9
	GJITHSEJ	35.0%	€843.4

10 SHTETET ME PLASMANET MË TË LARTA NDAJ GJITHSEJ MJETEVE


Nr.	SHTETI	PËRQINDJA	MJETET E FKPK
1.	SHBA	30.58%	€737,530,020
2.	Kosovë	29.97%	€722,802,173
3.	Francë	10.71%	€258,388,122
4.	Britani e Madhe	5.51%	€132,984,302
5.	Gjermani	3.41%	€82,235,887
6.	Itali	2.74%	€66,129,740
7.	Spanjë	2.08%	€50,136,546
8.	Irlandë	1.51%	€36,467,309
9.	Suedi	1.10%	€26,514,881
10.	Danimarkë	1.07%	€25,857,278
	GJITHSEJ	88.68%	€2,139,046,258

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE GLOBALE E GJITHSEJ MJETEVE



SHËNIM: FKPK-ja nuk mund të garantojë se performanca e investimeve në të ardhmen do të jetë sikurse në të kaluarën. FKPK-ja investon mjetet e saj nën menaxhim me qëllim që: së pari, të ruajë fuqinë blerëse të kursimeve pensionale dhe, së dyti, për t'ia rritur atyre edhe më shumë vlerën. Sidoqoftë, të gjitha investimet i nënshtrohen një niveli të riskut varësisht prej shkallës së kthimit të synuar. Kjo njësoj vlen edhe për investimet e FKPK-së, të cilat i nënshtrohen një sërë risqesh, por pa u kufizuar vetëm në to, sikurse janë: risku valutor, risku i normës së interesit, risku kreditor, risku i çmimit, risku politik, risku i palës tjetër, risku i likuiditetit, risku i derivativave e të tjerë. Më shumë detaje për secilin risk dhe ndërlikohen e tij sipas secilit fond investues prezantohen në pasqyrat financiare, të bashkëngjitura me këtë raport.

SHPËRNDARJA E GJITHSEJ MJETEVE SIPAS INSTRUMENTEVE FINANCIARE



2022	2021	2020	2020	2021	2022
Krijohet portofol i ri investues (Konservativ) që kontribuuesit afër pensionimit të mbrohen nga luhajat e shpejta. U reduktua në nivelin më të ulët ekspozimi ndaj instrumenteve me luhatshmëri të lartë.	Institucioni arriti vlerën nominale më të lartë të kthimit nga investimet në një vit. Numri i fondeve të angazhuara kapi rekord të ri në fundviti.	FKPK-ja mori çmim të rëndësishëm (nga IPE Awards) duke u vlerësuar mes më të suksesshmeve në Europë për vitin 2020 në "Menaxhimin aktiv të investimeve".	U përgatit procesi i aplikimit në distancë për tërheqjen e 10%-shit dhe gjatë dhjetorit aplikuan suksesshëm 397,557 persona. Numri i llogarive në eTrusti u dyfishua (në 255,903) duke përbërë kështu 36% të të gjitha llogarive.	Softueri i ri për menaxhimin e llogarive (IPSA) u përgatit nga stafi profesional i FKPK-së, duke zëvendësuar kështu softuerin paraprak të nënkontraktuar. Kalimi në këtë softuer (që u realizua gjatë janarit 2022) është avantazh i fuqishëm afatgjatë për insitucionin.	Vënia në punë e Portofolit Konservativ u bë pa asnjë vështirësi në softuerin IPSA. U shtua Kodi Digjital në pasqyra, ashtu që të mund të vërtetohet autenticiteti i tyre nga palët e treta. Po ashtu u mundësua shkarkimi pasqyrave edhe nga portali eKosova.
Kthimi neto për vitin ishte -5.5% për Portofolin Standard dhe +2.9% për Portofolin Konservativ. Mjetet nën menaxhim u ngritën për 2.5%.	Kthimi neto për vitin ishte +10.7% ndërsa mjetet nën menaxhim u ngritën për 18.4%.	Kthimi neto për vitin ishte +3.0% ndërsa mjetet nën menaxhim u ngritën për 1.1% më të larta.	Kontributet e paalokuara ranë në 0.08% të kontributeve të arkëtuara.	Kontributet e paalokuara u ngritën lehtë në 0.12% e kontributeve të arkëtuara.	Kontributet e paalokuara u ngritën në 0.13% e kontributeve të arkëtuara.

AKRONIME

FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
KUVENDI	Kuvendi i Republikës së Kosovës
QEVERIA	Qeveria e Republikës së Kosovës
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
BPV	Bruto Prodhimi Vendor (publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës)
ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
PTF	Programi i Tërheqjes në Faza (i kursimeve pensionale nga FKPK)
ETF	Fonde të tregtuara në bursë nga një broker, ku përmbledhen një sërë instrumentesh investuese (aksione, bono, mallra ose të përziera) që ndjekin një indeks të caktuar.

PËRKUFIZIME TERMASH

AKSIONE - Instrument financiar që siguron pronësi në kompani, varësisht nga shkalla e investimit.

PORTOFOL - Është përdorim i disa instrumenteve financiare si aksione, bono, para e gatshme, ETF dhe të tjera në një investim të përbashkët; rezultatet investuese të të cilave përllogariten së bashku dhe prezantojnë atë portofol.

LETRAT ME VLERË OSE FLETOBLINGACIONET - Instrument financiar i emtuar nga një qeveri ose korporatë, që ka një afat të caktuar të maturimit dhe që zakonisht paguan në afate të caktuara një shumë të bazuar në kamata fikse ose fleksibile.

MULTI ASETE - Fonde investuese që kanë në përbërje një përzierje të instrumenteve në klasat e aseteve kryesore financiare (aksione, bono dhe para e gatshme).

RREZIK INVESTUES - Nënkupton gjasat ose mundësitë që të pësohen humbje nga investimi i ndërmarrë kundrejt një niveli të caktuar të fitimit.

BENÇMARK - Një nivel standard referues për ta krahasuar dhe analizuar performancën e investimeve. FKPK-ja e ka si bençmark indeksin e çmimeve të konsumit të Kosovës, që ndryshe njihet si niveli i inflacionit në vend.

KONTRIBUT I DEFINUAR - Është një plan i përcaktuar i kontribuimit, ku kontributet fikse paguhen në një llogari individuale nga punëdhënësi dhe punëmarrësi. Më pas ato kontribute investohen dhe kthimet nga investimet (pozitive ose negative) i kreditohen llogarisë individuale. Në momentin e pensionimit kjo llogari përdoret për të ofruar përfitimin pensional, zakonisht përmes blerjes së anuitetit, i cili më pas mundëson të ardhura të rregullta mujore (variant ky ende i pa ofruar në Kosovë).


SHIFRA PËR PESË VJET

41.7%
RRITJA NETO E MJETEVE

11.1%
RRITJA E ÇMIMIT TË AKSIONIT

€357.7 mln
KTHIMI BRUTO NGA INVESTIMET

KTHIMI NGA INVESTIMET



NUMRI I LLOGARIMBAJTËSVE DHE DEMOGRAFIA E KONTRIBUESVE


VITI	LLOGARI GJITHSEJ	MESHKUJ	%	FEMRA	%	LLOGARI AKTIVE	MESHKUJ	%	FEMRA	%
	(A)	(B)	(B)/(A)	(C)	(C)/(A)	(D)	(E)	(E)/(D)	(F)	(F)/(D)
2018	626,687	426,960	67.9%	199,727	32.1%	344,453	229,515	66.6%	114,938	33.4%
2019	669,973	450,845	67.3%	219,128	32.7%	379,827	248,618	65.5%	131,209	34.5%
2020	707,388	469,286	66.3%	238,102	33.7%	387,526	249,355	64.3%	138,171	35.7%
2021	752,586	483,352	64.2%	269,234	35.8%	419,657	254,808	60.7%	164,849	39.3%
2022	792,995	507,028	63.9%	285,967	36.1%	428,891	262,339	61.2%	166,552	38.8%

MJETET NETO NËN MENAXHIM TË FKPK-SË KUNDREJT BPV-SË VJETORE TË KOSOVËS

	2018	2019	2020	2021	2022
Mjetet neto nën menaxhim (të njësuara)	€1,681,148,926	€1,966,956,583	€1,988,073,032	€2,353,174,912	€2,411,175,963
BPV e Kosovës	€6,671,522,000	€7,056,172,000	€6,771,600,929	€7,957,867,000 #	€8,237,333,000*
Mjetet neto kundrejt BPV së Kosovës	25.2%	27.9%	29.4%	29.6%	29.3%

KONTRIBUTET KUMULATIVE TË PAALOKUARA

RRITJA/RËNIA E KONTRIBUTEVE TË PAALOKUARA SI % E TOTALIT TË KONTRIBUTEVE



MJETET E MENAXHUARA NGA FKPK-JA NË FUND TË 2022-S KANË ARRITUR NË

29.3%
TË BPV-SË SË KOSOVËS

* SIPAS VLERËSIMIT TREMUJOR TË AGJENCISË SË STATISTIKAVE TË KOSOVËS
Vlerësimi i ASK për vitin 2021 sipas tremujorëve është korrigjuar në raportin vjetor të ASK



MISIONI DHE AMBICIA

Misioni ynë është t'i investojmë kursimet pensionale dhe t'i administrojmë llogaritë individuale të kontribuuesve deri në pensionimin e tyre.

Ne angazhohemi që misionin tonë ta arrijmë përmes investimeve të matura të mjeteve me procese të efektshme administrative.

Ambicia jonë është që t'i ofrojmë shërbimet më të mira të mundshme për kontribuuesit si dhe të jemi institucioni më i besuar në Kosovë.

Ambicien tonë përpiqemi ta arrijmë përmes profesionalizmit dhe integritetit të stafit si dhe transparencës institucionale.

PARATHËNIE E DREJTORIT MENAXHUES

E nderuara lexuese / I nderuari lexues,

raporti vjetor është publikimi më i rëndësishëm i FKPK-së, në të cilin, së bashku me pasqyrat e audituara financiare të bashkangjitura, shpalosen çështjet më kryesore të investimeve dhe të operacioneve të FKPK-së.

Viti 2022 ishte tejet sfidues për institucionin në rrafshin e investimeve. Numri i ngjarjeve të jashtëzakonshme, e që ndikuan negativisht në tregje, ishte shumë i lartë për një vit të vetëm. Përderisa pritej rimëkëmbje, meqë pandemia ishte në fundin e saj, invazioni i Rusisë në Ukrainë i dha goditje të rëndë rikuperimit pas-pandemik. Inflacioni vazhdoi të jetë shumë i lartë, e po ashtu kostoja e energjisë, dhe së bashku me ndikimet e tjera negative, injektuan dozë të madhe pasigurie në tregjet financiare.

Në këto rrethana, Bordi Drejtues i FKPK-së, i ndihmuar nga menaxhmenti, ndërmori një sërë vendimesh për të amortizuar sa më shumë ndikimin negativ në vlerën e kursimeve pensionale. Ishin mbi 70 lëvizje taktike të plasmaneve për të gjetur alokimin e duhur për menaxhimin e situatës së krijuar.

Këto vendime drastikisht ulën ekspozimin ndaj instrumenteve me luhatshtëri të lartë, sidomos aksioneve, gjë e cila ndikoi që viti 2022 të mbyllet me performancë negative prej 5.5%; në kohën kur indekset kryesore, dhe shumë fonde të tjera pensionale, pësuan rënie dyshifrore.

Krahas vendimeve taktike të cekura më lart, Bordi vendosi të ndryshojë mënyrën e investimit të mjeteve për ata kontribuues që janë afër pensionimit, me qëllimin që strategjia investuese për këta të fundit, të bartë risk më të ulët. Si rrjedhojë, në shkurt të vitit 2022, u krijua Portofoli Konservativ për kontribuuesit që kishin 18 muaj (ose më pak) para pensionimit. Në këtë portofol deri në 99% e mjeteve investohen në fletobligacionet e Qeverisë së Kosovës; ndërkohë që kthimin neto nga investimet nga shkurti e deri në fund të vitit e pati +2.9%.

Duhet theksuar se krijimi i Portofolit Konservativ ishte i mundur vetëm falë funksionalizimit të softuerit "IPSA", i cili fund e krye ishte zhvilluar nga vetë stafi i FKPK-së.

IPSA, i zhvilluar përgjatë viteve 2020-21, dhe i lansuar

më 1 janar 2022, thjeshtësoi dhe lehtësoi punën për të gjithë stafin. Në IPSA u konsoliduan në një platformë të vetme të gjitha proceset ekzistuese të FKPK-së (si psh kalkulimi i çmimit të njësisë, shërbimet për klientët e të tjera procese). Gjithashtu, u zhvilluan procese e mundësi të reja (si p.sh. krijimi i portfoleve shtesë, gjenerimi i pasqyrave të verifikueshme nga palët e treta etj.), si dhe u shfrytëzua rasti të ri-dizajnohet portali "eTrusti".

IPSA, një pronë intelektuale e FKPK-së, me kod burimor vetanak, do të mirëmbahet nga vetë stafi i TI-së, dhe nuk do të ketë nevojë për pagesë të kompanive për këtë qëllim; gjë që ofron kursim të konsiderueshëm.

Përgjatë vitit 2022 kishte nismë për ndryshimin e legjislacionit, në mënyrë që të lejohet tërheqja e parakohshme e (deri në) 30 për qind të mjeteve nga FKPK-ja. Kjo nismë, në dy raste të ndara, nuk u votua në Kuvendin e Kosovës. Përderisa misioni i FKPK-së është të synojë akumulimin sa më të madh të kursimeve për pjesëmarrësit e saj, çfarëdo tërheqje e parakohshme do të ulte bilancin përfundimtar të kontribuuesit me rastin e pensionimit.

Diskutimet rreth 30 përqindëshit, krahas krijimit të pritshmërive tek pjesëmarrësit, po ashtu rritën ndjeshëm fluksin e qytetarëve që kërkuar shërbime në zyrën e FKPK-së si dhe në zyrat rajonale të ATK-së. Jo vetëm që ky fluks i shtuar u menaxhua pa ngecje nga shërbimet për klientët, por gjatë vitit u avancuan tutje shërbimet digjitale të ofruara, përmes krijimit të mundësisë që pasqyra e FKPK-së të shkarkohet direkt nga platforma shtetërore "eKosova".

Sfidë për FKPK-në vazhdon të jetë përballja me largim të stafit me përvojë, sidomos atyre të TI-së, për shkak të mundësive më të mëdha në sektorin privat në Kosovë por dhe punës nga distanca për kompanitë e jashtme. Këto, së bashku me inflacionin e lartë, bëjnë që të ketë presion të lartë për korrigjime të kompensimeve të personelit në periudhat në vijim; gjithsesi nëse synohet që FKPK-ja të vazhdojë të jetë konkurruese me sektorin në të cilin vepron.

Për fund, e falënderojmë Kuvendin e Kosovës, së bashku me institucionet e tjera, për përkrahje dhe bashkëpunim përgjatë vitit; dhe besojmë fuqishëm se kjo do të vazhdojë edhe viteve në vijim.



01

ORGANIZATA DHE FINANCAT

Organizata, Bordi dhe Organogrami
Anëtarët e Bordit në fund të vitit
Procesi i vendimmarrjes së Bordit Drejtues
Komisionet e Bordit Drejtues
Administrata
Mbikëqyrja dhe auditimi
Financimi
Shpenzimet

ORGANIZATA

FKPK-ja është themeluar si institucioni i vetëm për menaxhimin dhe investimin e kontributeve të detyrueshme pensionale të të punësuarve, të punëdhënësve dhe të vetëpunësuarve në Kosovë, si dhe për administrimin e llogarive individuale të kursimeve pensionale deri në pensionim. FKPK-ja u themelua me Ligj në dhjetor të vitit 2001, si institucion jo për profit. Si i tillë, qëllimi i FKPK-së është t'i shërbejë vetëm interesit më të mirë të kontribuuesve të saj.

Në gusht 2002 FKPK-ja u funksionalizua në tërësi me Bord Drejtues, Administratë dhe vendosje të proceseve. Asokohe Administrata numëronte 22 punonjës dhe kishte pesë njësi. Administrata, prej atëherë, në mënyrë organike ka evoluar në 29 punonjës dhe tetë njësi. Gushti i vitit 2002 ishte po ashtu muaji në të cilin u arkëtuuan kontributet e para nga punonjësit e sektorit publik.

Më 2003, të vetëpunësuarit dhe të punësuarit e sektorit privat iu bashkëngjiten kursimit pensional. Ndërsa për herë të parë mjetet pensionale u investuan më 2003 në fonde të parasë së gatshme.

Investimet pasuan në aksione më 2004 dhe me investime në fonde që tregtonin me instrumente borxhi më 2006.

BORDI DREJTUES

FKPK-ja qeveriset nga Bordi Drejtues, anëtarët e të cilit përzgjidhen me konkurs publik, shqyrtohen nga Komisioni Përzgjedhës, propozohen nga Qeveria e Kosovës dhe emërohen me mandat katër-vjeçar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-101 i Republikës së Kosovës për Fondet Pensionale në Kosovë, bashkë me plotësimet dhe ndryshimet e tij (me Ligjin Nr. 04/L-168 dhe Ligjin Nr. 05/L116), shpjellon detajisht funksionimin dhe përgjegjësitë e FKPK-së dhe Bordit Drejtues.

Rregullat pensionale të BQK-së nxjerrin legjislacionin dytësor në lidhje me investimin e mjeteve pensionale, matjen e performancës, tërheqjen e kursimeve pensionale dhe kërkesat për raportim të FKPK-së. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Bordit Drejtues përfshijnë, por nuk kufizohen në: përzgjedhjen ose largimin e menaxhuesve të mjeteve, kujdestarëve, fondeve të hapura për investime si dhe palëve të treta; miratimin e parimeve dhe politikave për investimin e mjeteve pensionale; punësimin e personelit ekzekutiv dhe miratimin e pasqyrave të FKPK-së.


Më tutje investimet u zgjeruan duke shtuar fondet multi-asetëshe (më 2010) e fondet me target riskun (më 2011). Më 2014 e 2015 në portofolin investues u shtuan fondet investuese multi-asetëshe me menaxhim risku, ato të aksioneve me dividend si dhe me menaxhim risku. Më 2018 u përmbyll procesi i përzgjedhjes së brokerit për investime në fondet ETF, që i dha institucionit më shumë alternativa investuese. Më 2021 kishim rekord fondesh investuese dhe instrumente të përfshira ndonjëherë. Më 2022, si pjesë e masave mbrojtëse, u ulen ndjeshëm investimet në instrumente me risk të lartë.

Në Kosovë investimi i parë ndodhi në depozitat bankare më 2008, ndërsa investimi i parë në fletobligacione afatshkurtra të Kosovës u realizua më 2012. Më 2014 e 2015 u fillua me investimet në fletobligacionet afatmesme dhe afatgjata. Më 2020 arritën në nivele rekorde investimet në letrat me vlerë të Qeverisë, në afër €450 milionë. Më 2022 vazhduan me ritëm të njëjtë të investimeve në Kosovë.

Bordi Drejtues mund të ketë shtatë anëtarë me drejtë vote, dhe një anëtar pa të drejtë vote, që e përfaqëson Qeverinë e Kosovës. Por as gjatë vitit 2022 në Bordin Drejtues nuk është emëruar anëtar i përfaqësues i Qeverisë, pa të drejtë vote.

Së paku pesë nga anëtarët me të drejtë vote duhet të jenë profesionistë, me së paku dhjetë vjet përvojë në fushën e investimeve ose të menaxhimit të fondeve pensionale; së paku një anëtar me përvojë relevante për të përfaqësuar interesat e punëmarrësve në Kosovë, dhe së paku një anëtar me përvojë relevante për të përfaqësuar interesat e punëdhënësve në Kosovë.

Në fund të dhjetorit 2022 në Bordin Drejtues ishin pesë anëtarë të mbetur, të cilëve u ka skaduar mandati më 30 nëntor 2022. Atyre, sipas legjislacionit në fuqi, iu vazhdua mandati edhe për 90 ditë shtesë, deri më më 28 shkurt 2023, nga e cila datë FKPK-ja ka ngelur pa anëtarë në Bordin Drejtues. FKPK-ja i ka njoftuar me kohë të gjitha institucionet përgjegjëse për mandatin e secilit anëtar në Bordin Drejtues.



ANËTARËT E BORDIT DREJTUES NË FUND TË VITIT ¹⁾



Z. RUZHDI MORINA

Kryesues i Bordit Drejtues, Kryesues i Komisionit për Buxhet si dhe anëtar i Komisionit për Investime dhe Komisionit për Ankesa.

Doktor i shkencave juridike, drejtimi Ndërkombëtar. Më përvojë të gjatë në Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe me eksperiencë të dëshmuar profesionale rreth fondeve pensionale.

ROLI NË BORD:

Profesional

ZGJEDHUR:

Maj 2009

MANDATI AKTUAL:

I katërt



Z. FREDERICK ARTESANI

Kryesues i Komisionit të Investimeve dhe anëtar i Komisionit për Buxhet.

Ekonomist dhe këshilltar i pavarur financiar me mbi 39 vjet përvojë në tregjet financiare.

Profesional

Tetor 2008

I katërt



Z. BEHXHET HALITI

Anëtar i Komisionit të Investimeve dhe anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Komisionit të Auditimit.

I diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Prishtinës. Prej vitit 2003 është përfshirë në procesin e përpilimit dhe zbatimit të politikave fiskale në Kosovë.

Profesional

Dhjetor 2015

I dytë



Z. DRITON QEHAJA

Kryesues i Komisionit të Auditimit dhe anëtar i Komisionit të Investimeve dhe Komisionit të Ankesave.

Profesor i Asocuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" me gradën e doktorit të shkencave ekonomike dhe sociale.

Profesional

Gusht 2012

I dytë



Z. YMER YMERI


Kryesues i Komisionit të Ankesave dhe anëtar i Komisionit të Auditimit.

I diplomuar në Fakultetin e Shkencave Matematiko-natyrore dhe me titull magjistër i menaxhmentit. Për 15 vjet ka qenë mësimdhënës ndërsa prej vitit 2000 është angazhuar në SBASHK.

Përfaqësues i punëmarrësve


Dhjetor 2018

I parë



POZITË VAKANTE
prej shkurtit 2022

Anëtar përfaqësues



POZITË VAKANTE
prej shkurtit 2021

Anëtar profesional

¹⁾ Mandati i pesë anëtarëve të Bordit Drejtues në detyrë ka përfunduar më 28 shkurt 2023.

FALËNDERIM!

FKPK ua shpreh mirënjohjen të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues që i kanë shërbyer institucionit përgjatë mandatit të fundit!

PROCESI I VENDIMMARRJES SË BORDIT DREJTUES PËR INVESTIMET

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË

FKPK-ja qeveriset nga Bordi Drejtues. Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues është për administrimin në mirëbesim të mjeteve pensionale.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Bordit përfshijnë, por nuk janë të kufizuara: në adoptimin e parimeve dhe politikave për investimin e mjeteve pensionale; definimin e alokimit strategjik të mjeteve për fondet e FKPK-së si dhe përcaktimin e natyrës dhe shumave të çfarëdo ndryshimi në alokim, strategji dhe politikën investuese; përzgjedhjen, monitorimin dhe largimin e instrumenteve të hapura dhe menaxhuesve të mjeteve që zbatojnë strategjinë investuese dhe alokimin e definuar të mjeteve; përzgjedhjen e kujdestarëve të mjeteve dhe palëve të treta; rekrutimin e personelit ekzekutiv të FKPK-së dhe miratimin e pasqyrave financiare të FKPK-së. Detyra parësore e Bordit Drejtues të FKPK-së është që të sigurojë që mjetet nën menaxhim janë investuar në mënyrë të kujdesshme dhe në pajtim me kërkesat e Ligjit dhe brenda kornizës së tij të parimeve dhe politikës investuese. Bordi Drejtues e pranon se ka përgjegjësi fiduciare kundrejt pjesëmarrësve dhe përfituesve në FKPK, dhe se do të ndjekë vetëm politikat që nuk e cenojnë këtë përgjegjësi.

INFORMIMI I BORDIT DREJTUES

Menaxhmenti dhe stafi i FKPK-së i informojnë në baza të rregullta (ditore, javore, mujore ose sipas nevojës) anëtarët e Bordit Drejtues me performancën e investimeve të FKPK-së, me gjendjen e kontributeve të pranuar dhe mjeteve të paineduara, me maturimin e investimeve në fletobligacionet e Kosovës dhe depozitat bankare, me ndarjen e investimeve sipas klasave dhe strategjive investuese, dhe e gjithë kjo në raport me ruajtjen e kufijve investues - sipas legjislacionit në fuqi.

INVESTIMI I MJETEVE PENSIONALE

Bordi Drejtues i merr vendimet fiduciare duke realizuar investimin e të gjitha mjeteve pensionale të grumbulluara (dhe kontributeve në vazhdim): për tërheqjen ose përfshirjen e investimeve të reja në fondet e përzgjedhura sipas Parimeve Investuese dhe Politikës së adoptuar, për alokimin e detajuar të mjeteve siç është pasqyruar në matricën e investimeve, për investimet direkte – përfshirë këtu investimet në fletobligacionet e Qeverisë së Kosovës dhe depozitat bankare. Bordi Drejtues, në pajtim me analizat dhe informacionet e ofruara (përmes stafit dhe menaxhmentit të FKPK-së, por edhe përmes anëtarëve profesionalë në Bord) merr vendime për të shtuar ose hequr investime nga klasat e mjeteve (aksione, multi-asete, instrumente borxhi, tregun e parasë) duke bërë kështu balancimet e nevojshme në linjë me analizat e secilit fond.

Njësia e investimeve dhe riskut, së bashku me Komisionin e Investimeve të Bordit Drejtues, dhe në pajtim me Manualin e Investimeve të FKPK-së, përmes rekomandimeve të ndryshme, duke ngërthyer parashikimet ekonomike, ndryshimet e politikave financiare, ndryshimet e sjelljeve në tregje, publikimeve të rezultateve të kompanive dhe sektorëve, por edhe çfarëdo faktori tjetër që ndikon investimet aktuale ose potenciale, ndihmon në menaxhimin aktiv të investimit të mjeteve. Këto rekomandime kanë për qëllim të përmirësojnë kthimet nga investimet me risk të menaxhuar, gjithnjë brenda mandatit të FKPK-së: për investime të kujdesshme në afatgjatë.


Përpara se çfarëdo fondi investues të angazhohet, ai kalon një procesi të përzgjedhjes (prej thirrjes ndërkombëtare për shprehje të interesit, deri tek studimi dhe intervistimi i detajuar i fondeve të tilla) që përfshin: një analizë të detajuar e matësve të fondit investues dhe indikatorëve të investimit, ashtu sikurse edhe studimin e hollësishëm të parimeve investuese dhe metodologjisë së secilit fond. Kjo zakonisht kërkon angazhimin e një pale të tretë të specializuar, me një kosto jo të papërfillshme, por në këtë rast FKPK-ja përfiton nga kualifikimet dhe përvoja profesionale e anëtarëve të Bordit Drejtues që e bëjnë vetë këtë. Në anën tjetër, investimet në Kosovë ndërmerren brenda kornizës së kushteve mbizotëruese të tregut për instrumentet sovraane me të ardhura fikse si dhe vlerësimin e rrezikut relativ të emetuesit.

RAPORTIMI DHE TRANSPARENCA

FKPK-ja i publikon në uebfaqe të gjitha vendimet e rëndësishme të Bordit Drejtues (që lidhen me investimin e mjeteve), si dhe në baza ditore publikon në uebfaqe performancën e investimeve. Bordi Drejtues dërgon raporte të detajuara (tremujore dhe vjetore) tek institucionet mbikëqyrëse.

Më shumë sesa kaq, anëtarët e Bordit Drejtues zhvillojnë takime direkte me anëtarët e komisioneve funksionale të Kuvendit të Kosovës, si për të prezantuar performancën e investimeve ashtu edhe për kërkesën e FKPK-së drejtuar Kuvendit të Kosovës për caktimin e tarifave për financim. E njëjta procedurë vlen edhe për miratimin e raportit vjetor. FKPK-ja, përmes Menaxhmentit ose Bordit Drejtues, është e prirshme t'i përgjigjet me transparencë të gjitha kërkesave për informacione të medieve relevante, duke shpalosur në detaje performancën dhe të dhënat e tjera rreth investimeve të FKPK-së.

CIKLI I VENDIMMARRJES SË BORDIT DREJTUES



Katër komisione të përhershme mbështesin funksionimin dhe vendimmarrjen e Bordit.

KOMISIONI I INVESTIMEVE
Kryesisht shqyrton politikën, parimet dhe strategjinë e investimit të mjeteve pensionale, ashtu sikurse performancën e investimeve dhe fondeve të hapura investuese përmes të cilave FKPK-ja i investon mjetet. Komisioni e shqyrton, gjithashtu, edhe pajtueshmërinë e investimeve me kërkesat ligjore dhe të rregullatorit. Komisioni i bën rekomandime Bordit për investimin dhe tërheqjen e mjeteve pensionale.

KOMISIONI I AUDITIMIT
Në mesin e funksioneve shqyrton raportet e rregullatorit dhe auditorit, dhe i rekomandon Bordit ndërmarrjen e planit të nevojshëm të veprimit për t'i trajtuar gjetjet dhe çështjet. Komisioni, po ashtu, shqyrton përshtatshmërinë e procedurave të brendshme, dhe në rast nevojë rekomandon ndryshime. Komisioni e shqyrton planin e auditimit për funksionet e auditimit të brendshëm, shqyrton kriteret për auditorin e jashtëm dhe rekomandon adoptimin e tyre nga Bordi.

KRYESUES:	Frederick Artesani
ANËTARË:	Ruzhdi Morina Behxhet Haliti Driton Qehaja
TAKIME TË MBAJTURA:	Pesë

Driton Qehaja
Behxhet Haliti Ymer Ymeri Mirlinda Ahmeti (anëtare e jashtme)
Katër

KOMISIONI PËR ANKESA
Shqyrton kërkesat, pretendimet dhe ankesat e kontribuuesve që i drejtohen Bordit ose FKPK-së. Komisioni ia paraqet Bordit rekomandimet dhe siguron që të gjitha rasteve t'i jepet përgjigje brenda afateve dhe në pajtueshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

KOMISIONI PËR BUXHET
Shqyrton nevojat buxhetore të FKPK-së dhe sipas tyre i jep rekomandime Bordit për nivelin e tarifave që duhen ngarkuar mbi mjetet pensionale. Komisioni gjithashtu i rekomandon Bordit miratimin e buxhetit dhe (kur ka nevojë) ndryshimeve në buxhet. Komisioni po ashtu shqyrton shpenzimet e FKPK-së kundrejt buxhetit.

KRYESUES:	Ymer Ymeri
ANËTARË:	Ruzhdi Morina Driton Qehaja
TAKIME TË MBAJTURA:	Tri

Ruzhdi Morina
Frederick Artesani Behxhet Haliti
Tri

Administrata e FKPK-së drejtohet nga Menaxhmenti i lartë, i cili përbëhet nga Drejtori Menaxhues dhe dy zëvendës drejtorë: njëri për financa, investime e risk dhe TI e tjetri për operacione dhe burime njerëzore.

Menaxhmenti synon që të angazhojë në FKPK individë efektivë, profesionalë dhe moralisht të shëndoshë, duke besuar se vetëm këto cilësi do të çojnë në progres më të madh, mjedis të shëndoshë pune e në shërbime më të mira për kontribuuesit; dhe, njëkohësisht, në ruajtje të integritetit institucional të FKPK-së.

Për t'i arritur objektivat e mësipërme, Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti, duhet të sigurohen që Administrata aktuale vazhdon t'i përmirësojë njohuritë dhe përvojën e saj, vazhdon të jetë e motivuar dhe vazhdon të vë në funksion gjithë kapacitetet mendore dhe profesionale në shërbim të avancimit të proceseve të brendshme dhe shërbimeve për klientë. Administrata është e ndarë në njësi funksionale, për të siguruar kështu efektivitet dhe efikasitet në punë.

Realizimi i detyrave ditore (në të gjitha fushat operuese) përmirësimi i proceseve administrative, dhënia e ndihmës Bordit Drejtues për analizën e investimeve, si dhe implementimin e vendimeve të Bordit, janë detyrat kryesore të Administratës. Performanca e saj mbikëqyret në vazhdimësi nga Bordi Drejtues, ndërkaq udhëhiqet e zhvillohet në baza ditore nga Menaxhmenti.

Në vitin 2022 pozita të përhershme ishin 29, prej të cilave dy janë me angazhim të pjesshëm (më 2021: 28 pozita të përhershme - njëra me orar të pjesshëm).

Në qershor 2022 u pensionua një anëtar i stafit. Ishte i pari i tillë për FKPK-në, pasi ishte punësuar në fund të vitit 2006 si kontabilist.

Institucioni po përballlet me vështirësi të mbajtjes së stafit, sidomos të teknologjisë së informacionit. Mundësitë e punësimit për kompani të jashtme, qoftë përmes punësimit në distancë qoftë për outsource shërbime të ofruara në Kosovë, janë në rritje të vazhdueshme dhe kësaj presionet për mbajtje të stafit, dhe rritje pagash ndaj FKPK-së janë në rritje të pandalshme. Gjatë vitit ka pasur dy dalje të stafit seniorë.

Gjatë vitit, tek shërbimi për klientë, janë angazhuare edhe praktikantë, për t'iu mundësuar atyre krijimin e përvojës profesionale. Angazhime të tilla do të synohet të realizohen edhe në njësinë e teknologjisë së informacionit më 2023.

Punonjësit pjesëtarë të minoriteteve më 2022 përbënin 7% të fuqisë punëtore (7% të atyre që e kanë deklaruar përkatësinë etnike). Femrat përbënin 41% të stafit (2021: 33%); 90% e stafit ishin më të vjetër se 35 vjet (2021: 85%), dhe 3% e stafit ishin me aftësi të kufizuara fizike të përhershme. Më lëvizjet e stafit të përhershëm këtë vit, moshë mesatare e stafit u ngrit lehtësisht nga viti i shkuar në 45.2 vjeç (2021: 44.7 vjeç).

1 DREJTOR MENAXHUES

NJËSIA	SHËRBIMET PËR KLIENËTË	TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT	FINANCAT	INVESTIMET DHE RISKU
POZITA TË PËRHERSHME	8	5	3	3
POZITAT	1 menaxher i njësisë 6 këshilltarë pensionalë 1 recepsion	1 menaxher i njësisë 2 zhvillues të programeve 1 administrator i rrjetit 1 administrator i bazës së të dhënave	1 kontabilist 2 zyrtarë për financa	1 menaxher i njësisë 2 zyrtar për investime dhe risk
PËRSHKRIMI	Ofron shërbimet ndaj klientëve. Kujdeset të informojë për llogaritë individuale që nga pagesa e kursimeve pensionale, bilancet e kursimeve dhe po ashtu këshillon pjesëmarrësit mbi pensionet e asistion ata për tërheqje të kursimeve. Mirëmban marrëdhëniet edhe me punëdhënësit me qëllim të përmirësimit të informacionit për t'i barazuar kontributet në llogaritë individuale. Në përgjithësi, ky staf është afër klientit gjatë gjithë ciklit të kursimit deri në pensionim.	Sigurojnë që e gjithë infrastruktura e teknologjisë së informacionit funksionon gjithë kohën e pa probleme: kujdesen për harduerët, softuerët, licencat, rrjetin e jashtëm e të brendshëm të FKPK-së, sigurinë e të dhënave dhe ruajtjen e të dhënave. Kujdesen që plani i rimëkëmbjes është çdo ditë i vlefshëm dhe e testojnë në baza të rregullta.	Kryejnë të gjitha transaksionet financiare, përfshirë investimin dhe tërheqjen e mjeteve në tregjet financiare; bëjnë llogarimbajten dhe kontabilitetin për mjetet pensionale dhe operacionet e FKPK-së. Kalkulojnë çmimin ditor të aksionit (për dyja portofolet) dhe përgatisin pasqyrat financiare, raportet mujore e tremujore dhe raportet e tjera të nevojshme për Bordin e FKPK-së, Rregullatorin dhe Kuvendin, si dhe komunikojnë me menaxhuesit e mjeteve.	Përgatisin analizat mbi: ecurinë e investimeve; riskun dhe luhatshmërinë e portofolios investuese; përputhshmërinë e investimeve me ligjin; mirëmbajtjen e strategjisë investuese të Bordit, përditësimin e dokumentit kryesor të Fondit dhe materialeve të tjera sipas kalendarit të raportimeve ose kërkesave nga Menaxhmenti e Bordi Drejtues.

2 ZËVENDËSDREJTORË

BURIMET NJERËZORE DHE ADMINISTRATA	ZYRA LIGJORE	AUDITORI I BRENDSHËM	MARRËDHËNIET ME PUBLIK, TRAJNIMET DHE PËRKTHIMET
3	1	1	2
1 zyrtar i BNU 1 shtëpiak 1 zyrtar i sigurimit	1 zyrtar ligjor	1 auditor i brendshëm	1 menaxher i njësisë 1 zyrtar për marrëdhënie me publik, koordinimin e trajnimeve dhe përkthimeve
Kujdesen për listëprezencën e stafit në punë, respektimin e orarit, përgatitjen e listës së pagave, kompensimeve të tjera dhe mbajnë arkën. Përveç këtyre merren me furnizimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e zyrës; mbajnë arkivin e dokumenteve të institucionit; mbështesin stafin dhe Bordin Drejtues në takime e udhëtime, brenda e jashtë vendit.	Zyra ligjore shqyrton ligjshmërinë e gjithmbarshme të institucionit karshi legjislacionit në fuqi dhe ndihmon në përpilimin e kontratave, marrëveshjeve; jep opinione ligjore dhe e përfaqëson FKPK-në në sistemin gjyqësor. Nën Zyrën ligjore është edhe koordinimi i aktiviteteve të prokurimit me Agjencinë Qendrore të Prokurimit.	Siguron Bordin se e gjithë veprimtaria e Menaxhmentit dhe Administratës dhe proceset në FKPK janë në përputhje me procedurat e brendshme, rregullat e BQK-së dhe ligjet në fuqi. Siguron efektivitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit të FKPK-së dhe kontroleve të brendshme duke zhvilluar auditime të rregullta tremujore dhe ofruar rekomandime për zgjidhjen e çështjeve të ngritura. Raportet e Auditorit shqyrtohen nga Komisioni i Auditimit dhe Bordi Drejtues.	E ndërtojnë dhe e mbështesin komunikimin e institucionit me median, publikun dhe institucionet, zhvillimin e intervistave dhe konferencave, përpilimin e raportit vjetor dhe buletinit tremujor për kontribuuesit; administron uebfaqen dhe (menaxheri i njësisë) e merr rolin e zëdhënësit, kur i delegohet; koordinon dhe ndihmon përkthimin e dokumenteve; koordinon procesin e trajnimeve, kur ka nevojë.

MBIKËQYRJA DHE AUDITIMI

FKPK-ja mbikëqyret dhe inspektohet nga ekzaminerët BQK-së, ndërsa auditohet nga auditori i brendshëm dhe i jashtëm.

FKPK-ja, si një institucion publik i pavarur, është subjekt i mbikëqyrjes nga rregullatorët dhe i auditimit nga auditorë të pavarur dhe profesional. Të gjitha këto mbikëqyrje dhe kontrole financiare, nga të cilat nuk kanë rezultuar me gjetje madhore që prej inicimit të aktivitetit të FKPK-së (më 2002), kanë vazhduar besimin e institucionit tek palët e treta.

Njëkohësisht, Bordi beson se këto mbikëqyrje bashkë me performancat e investimeve, kanë forcuar kredibilitetin dhe rritur besimin e publikut të gjerë në vendimmarrjen e Bordit dhe etikën e punës së Menaxhmentit.

Kështu, FKPK-ja çdo tremujor i njofton: BQK-në, Kuvendin dhe Qeverinë për plasmanet e fondeve pensionale, investimet e reja, kthimin nga investimet, por edhe për harmonizimin e mjeteve pensionale. Ky informacion publikohet gjithashtu edhe në uebfaqen e FKPK-së për informim të publikut.

Deri më tani historikisht secili auditor i pavarur që ka bërë auditimin e pasqyrave financiare të FKPK-së (operacionale dhe të mjeteve pensionale), të përzgjedhur përmes procedurave publike të prokurimit dhe të miratuara nga Banka Qendrore e Kosovës, nuk kanë dhënë opinion të kualifikuar mbi ato pasqyra. Auditori i Jashtëm, përmes letrës së menaxhmentit, mund të japë edhe rekomandime për funksionimin më të mirë të proceseve të FKPK-së.

Përveç raportimit tremujor, mbi përputhshmërinë e investimeve me dispozitat ligjore dhe Rregullat e BQK-së për pensionet, edhe përgjatë 2022-s FKPK-ja çdo muaj i raportoi departamentit të mbikëqyrjes pensionale në BQK për të gjitha aspektet investuese dhe gjendjen e përgjithshme të mjeteve pensionale.

Gjithashtu janë dhënë shpjegime dhe të dhëna sa herë është kërkuar nga BQK-ja. Në rast se investimet e FKPK-së, për shkak të lëvizjeve në tregjet financiare, rastisin të mos jenë në pajtim me ligjin, atëherë FKPK-ja është e obliguar që menjëherë ta njoftojë BQK-në, dhe ka afat prej 180 ditësh për ta sanuar gjendjen. Gjatë vitit 2022 nuk kishte ndonjë rast të tillë.

Deri më 31 maj të çdo viti, FKPK-ja përpilon dhe e dërgon në BQK, Kuvend dhe Qeveri raportin vjetor për vitin paraprak, së bashku me pasqyrat financiare të audituara nga një auditor i pavarur, i cili përzgjidhet vetëm pas pëlqimit të BQK-së. Raporti vjetor, bashkë me pasqyrat financiare, po ashtu publikohet në uebfaqe.

Gjatë vitit BQK-ja e ka finalizuar inspektimin për vitin 2020, ku një numër i madh i dokumenteve është shqyrtuar; që nga procesverbalet e mbledhjeve të Bordit dhe Komisioneve e deri tek të gjitha çështjet investuese dhe operacionale. BQK-ja përgatit raport të detajuar, të cilin ia dërgon Bordit Drejtues të FKPK-së. Bordi e shqyrton raportin dhe jep komente.


Në rast të gjetjeve serioze BQK-ja duhet gjithashtu t'i raportojë Kuvendit, një veprim i cili deri më tani nuk ka qenë i nevojshëm. Përveç gjetjeve, BQK-ja i bën Bordit Drejtues edhe rekomandime. FKPK-ja e njofton BQK-në edhe për të gjitha vendimet e Bordit që kanë të bëjnë me kontribuuesit, qeverisjen e fondit dhe çështjet e tjera.

FKPK-ja e ka të punësuar një auditor të brendshëm, i cili i raporton së paku katër herë në vit Komisionit për Auditim të Bordit Drejtues të FKPK-së mbi të gjitha aspektet e aktiviteteve të institucionit. Me kërkesë të Bordit Drejtues, gjatë vitit 2022 Auditori i Brendshëm i ka realizuar edhe dy raporte ad hoc të auditimit preliminar të testimit të disa proceseve të sistemit të ri të mbajtjes së të dhënave IPSA-s (para lansimit në bazën test dhe pas lansimit). Nga viti 2022 është kontraktuar edhe kompania e specializuar për auditimin e brendshëm të TI-së, e cila do të bëjë auditimin e TI-së së FKPK-së për tri vjetët e ardhshëm.

FKPK-ja prej 2018 vazhdon ta ketë të angazhuar një anëtare të jashtme në Komisionin e Auditimit, sipas kërkesës së Ligjit Nr. 05/L-116, i cili e ndryshon Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë, e cila është e pavarur nga Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK-së.

REKOMANDIME TË NGRITURA NGA AUDITORI I JASHTËM DHE AUDITORI I BRENDSHËM MË 2022 DHE ECURIA

	REKOMANDIMET	ECURIA/KOMENTI
AUDITORI I JASHTËM	<p>Mungesa e anëtarëve të Bordit nënkupton që nuk mund të ketë qeverisje apo vendimmarrje thelbësore në institucion.</p> <p>- Të vendoset SSL certifikata tek serveri i softuerit administrativ.</p> <p>- Të ofrohet 2FA për zyrtarët pensionalë të ATK-së.</p>	<p>Konkursi për anëtarë të Bordit Drejtues është rishpallur në prill 2023.</p> <p>Këto rekomandime do të implementohen gjatë vitit 2023.</p>
AUDITORI I BRENDSHËM	<p>Kur personi i njëjti ka më shumë se një llogari kursimesh (për shkak se posedon më shumë se një numër personal), në mënyrë që kursimet t'i bashkohen në një, duhet plotësuar Formulari për bashkimin e llogarive. Formularët ruhen, por nuk janë të sistematizuar me periudha apo punëdhënës. Në disa raste të kufizuara mungojnë: (a) data se kur është parashtruar kërkesa; (b) nënshkrimi i zyrtarëve që e kanë pranuar kërkesën; ose (c) dokumentet mbështetëse origjinale (të bashkangjitura ose jo). Mungesa e dokumentimit dhe sistematizimit të duhur, në rast të kontestit, mund ta sjell FKPK-në në situatë të palakmueshme.</p> <p>Ndër të tjera, kartelat bankare pranohen si dëshmi për llogarinë bankare në të cilën një përfitues dëshiron t'i pranojë mjetet e tërhequra. Mirëpo, në to gjendet numri dhe informacione të tjera të kartelës. Ndonëse nga themelimi i FKPK-së nuk dihet për ndonjë rast të keqpërdorimit të informacionit nga kartelat e përfituesve, megjithatë ruajtja e tyre lë hapësirë për keqpërdorimin e tyre (për blerje në internet apo gjetkë); andaj rekomandohet që ky lloj dokumentacioni të mos pranohet më.</p> <p>Gjatë testimit të rimëkëmbjes nga fatkeqësitë (dhjetor 2022) është vërejtur që ngritja e makinave (serverëve) në lokacionin e rimëkëmbjes nuk ka funksionuar për shkak të IP adresave. Po ashtu, edhe disa makina të tjera (si psh Intraneti) - si dhe ngritja e backupëve (backup extractions) - nuk ishte e mundur për arsye të skadimit të licencës së VEAM Backup. Gjithsesi këto probleme duhen sanuar ashtu që rimëkëmbja të jetë funksionale.</p>	<p>Menjëherë ka filluar të zbatohet rekomandimi që formularët të plotësohen me data dhe nënshkrime në tërësi. Po ashtu, është krijuar mundësia që dokumentet (e skanuara) të bashkangjiten direkt kundrejt llogarisë së personit në IPSA.</p> <p>FKPK-ja menjëherë ka filluar të mos i pranojë më kartelat bankare, por pranon vetëm konfirmimet e llogarisë të lëshuara nga bankat.</p> <p>Pas sanimeve të nevojshme, testimi është përsëritur në shkurt 2023, dhe ka rezultuar i suksesshëm në tërësi.</p>



Tarifat vjetore të ngarkuara mbi mjetet pensionale për vitin 2022 janë ulur në gjithsej në 0.377% të mjeteve (2021: 0.385%).

Tarifa investuese nuk është ndryshuar nga viti paraprak, prej 0.320%, gjersa tarifa operationale është ulur lehtësisht në 0.057% (2021: 0.065%). Por në vlerë nominale tarifata e ngarkuara mbi mjetet pensionale për vitin 2022 u ngritën për 4.2%, ose me €357,408 - për shkak të ngritjes së mjeteve nën menaxhim.

Tarifata e ngarkuara për vitin 2022 ishin në vlerë €8,849,446 (2021: €8,492,038). Prej të cilave €7,511,466 (2021: €7,090,416) ishin destinuar për t'i mbuluar shpenzimet investuese dhe €1,337,980 (2021: €1,401,622) ishin për shpenzimet operationale.

Buxheti i planifikuar për vitin 2022 nuk është shpenzuar në tërësi. Si rezultat suficiti nga buxheti për shpenzimet investuese dhe operationale ishte €1,080,573. Megjithatë ky suficit ose të shërbejë për financimin e buxhetit për vitin vijues (2023), me çka do të ulte normën e tarifës për vitin përkatës, ose do të kthehet në fondin pensional.

Të ardhurat jo-tarifore të FKPK-së për vitin ishin €80,623 (2021: €126,087), duke bërë që të hyrat e përgjithshme të FKPK-së për vitin 2022 të jenë €8,930,069, ose 3.6% më të larta sesa një vit më parë (2021: €8,618,125).

Gati 99% e të hyrave jo-tarifore ishin prej interesit në depozita dhe llogarinë e parasë së gatshme në bankë.

FINANCIMI

FKPK-ja financohet në mënyrë të ngjashme sikurse të gjitha fondet pensionale me kontribut të definuar, d.m.th. duke ngarkuar tarifa mbi mjetet nën menaxhim (mjetet pensionale).

Si një institucion jo-për-profit, tarifata e ngarkuara nga FKPK-ja ndaj llogarive të kontribuuesve duhet t'i mbulojnë vetëm shpenzimet e saj. Nivelet e tarifave, sipas rekomandimeve të Bordit Drejtues, miratohen nga Kuvendi i Kosovës; duke i siguruar kështu Kuvendit një mënyrë të tërthortë një nivel të kontrollit mbi shpenzimet e FKPK-së.

Sipas ndryshimeve në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-168, FKPK-ja ngarkon tarifën investuese për të mbuluar shpenzimet që lidhen me investimin e mjeteve pensionale dhe tarifën operationale për mbulimin e shpenzimeve të tjera.

Krahasuar me 2021 FKPK-ja i ka ulur për 2022 tarifata e ngarkuara (në përqindje) për aktivitetet operationale ndërsa e ka mbajtur të njëjtë tarifën për investime.

Tarifa operationale e FKPK-së, sivjet prej 0.057% vjetore, vazhdon të jetë më e ulëta krahasuar me të gjithë operatorët e ngjashëm në rajon por është edhe ndër më të ulëta globalisht.

Në anën tjetër, mënyra e aplikimit e tarifës investuese (prej 0.320% vjetore) nuk është e krahasueshme me asnjërin prej fondeve të ngjashme pensionale rajonale por as me fondet e ngjashme në botë.

Forma standarde e trajtimit të shpenzimeve investuese nga fondet e ngjashme pensionale është që, krahas taksës operationale që ngarkohet për operim të shtëpisë menaxhuese, shpenzimet investuese të ngarkohen mbi vetë fondin pensional; pra shpenzimet investuese të trajtohen si shpenzime të fondit e jo siç e kemi në Kosovë, ku këto trajtohen si shpenzime të entitetit që e menaxhon fondin. Ky trajtim po rezulton në shpërputhje midis asaj që FKPK-ja ngarkon si tarifë investuese (gjë që duhet vlerësuar para se viti të fillojë) dhe shpenzimeve që ndodhin në realitet (pasi përfundon viti).

Duhet sqaruar këtu se edhe disa prej aktiviteteve të Bordit Drejtues, të lidhura me investimet, si: intervistimi dhe përzgjedhja e aset-menaxherëve, që janë aktivitete të ndërlidhura me investimet, mbulohen po nga tarifa operationale. Llogaritur në mesatare, FKPK-ja i ka ngarkuar kontribuuesit për vitin 2022 për shpenzimet operationale me nga €0.15 në muaj ose €1.82 euro për gjithë vitin.

Tabela: Lista e shërbimeve që FKPK-ja i ofron për kontribuuesit

1.	Shërbimin e drejtpërdrejtë në zyrë (shërbim, këshillim, informim) çdo ditë pune prej orës 08:00 deri 16:00	7.	Njoftimin me postë elektronike dhe fizike për daljen në pension
2.	Dërgimin e pasqyrave vjetore në shtëpi ose përmes postës elektronike	8.	Aplikimin për tërheqje kursimesh dhe transferet bankare pa kosto të ngarkuar nga FKPK-ja
3.	Shtypjen e pakufizuar të pasqyrave të llogarisë në zyrën e FKPK-së	9.	Mirëmbajtje falas të llogarisë për tërheqje të kursimeve në faza nga bankat komerciale në vend
4.	Mirëmbajtjen e plotë të llogarisë së kursimeve pensionale	10.	Kontratë me bankat për kamatë mbi mesatare për kursimet në programin për tërheqje në faza
5.	Sigurimin e llogarisë në një lokacion dhe me serverë rezervë	11.	Mbulimin e një pjese të shpenzimeve investuese; përzgjedhjen e menaxhuesve të mjeteve, shpenzimet e Bordit Drejtues e të ngjashme
6.	Shërbimin elektronik të qasjes online në llogarinë personale pensionale dhe shërbimin për komunikim në Facebook	12.	Shkarkimin e pasqyrës nga portali eKosova

SHPENZIMET

FKPK-ja, si shtëpi menaxhuese e fondit, ka shpenzime për investimin e mjeteve pensionale dhe për operacionet e saj.

SHPENZIMET INVESTUESE

Shpenzimet investuese përfshijnë: tarifat që mbajnë menaxhuesit e fondeve për investimin e mjeteve dhe qasjen në tregjet financiare; tarifat e BQK-së për transferimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve; dhe shpenzimet e tjera për brokerët dhe kujdestarët e mjeteve.

Bordi Drejtues gjatë procesit konkurrues të përzgjedhjes së fondeve investuese i merr për bazë tarifat që menaxherët i ngarkojnë për investimin e mjeteve. Menaxhuesit që ofrojnë tarifa më të ulëta kanë përparësi në përzgjedhje. Po ashtu duhet pasur parasysh që menaxherët e fondeve ngarkojnë tarifa të ndryshme të menaxhimit në varësi të shumës së investuar si dhe strategjisë së tyre (aktive ose pasive).

Po ashtu kthimi potencial i mundshëm ka ndikim në tarifat menaxhuese. Fondet investuese të tregut të parasë (si shembull) ngarkojnë tarifa menaxhuese më të ulëta sesa fondet në tregjet e aksioneve apo edhe fletobligacioneve.

Për vitin 2022 shpenzimet për investime përbënin 85.5% të shpenzimeve të FKPK-së (2021: 85.2%). Ato në vlerë nominale ishin €6,695,395 (2021: €6,840,347). Nga këto, €6,040,583 ishin për fondet investuese të përdorura, ndërkaq €654,812 për shpenzime transferesh nga BQK-ja dhe ato të tregtimit të brokerëve dhe kujdestarisë.

Niveli i realizimit të shpenzimeve të parashikuara për tarifën investuese për 2022 ishte 89.1% (2021: 96.5%).

Ulja e nivelit të realizimit të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2022, krahasuar me vitin 2021, ndërlidhet me kostot e angazhimit të fondeve investuese këtë vit kundrejt vitit paraprak. Fondet investuese me kthim potencial (dhe risk) më të lartë kanë edhe kosto më të lartë të angazhimit kundrejt atyre me kthim potencial (dhe risk) më të ulët.

Meqë realizimi i shpenzimeve investuese për vitin 2022 nuk është arritur plotësisht, nga buxheti për shpenzimet investuese për vitin 2022 ka ngelur shuma e suficitit prej €816,071. Kjo vlerë e suficitit do të përdoret ose për të financuar shpenzimet investuese për vitin 2023 dhe/ose do të kthehet tek mjetet pensionale deri në fund të vitit 2023.

Duhet theksuar në këtë analizë se në momentin kur përcaktohet tarifa investuese për vitin e ardhshëm synimi i FKPK-së është të jetë sa më afër me vlerësimin e nevojave për të njëjtën. Por, është tejet e vështirë të parashikohet qoftë performanca e investimeve e qoftë alokimi strategjik i mjeteve (për shkak të faktorëve të jashtëm të cilët mund të ndikojnë edhe në tregje e edhe në vendimmarrjen e Bordit Drejtues për investime). Këto e bëjnë të pashmangshëm suficitin (ose deficitin) nga aktivitetet investuese.

Vlen kujtuar se (zakonisht) fondet investuese të menaxhimit aktiv ngarkojnë mesatarisht 0.5% deri 1.0% për menaxhimin e fondeve. Ndërkaq, ETF-të kanë tarifa nga 0.2% e deri në 0.7%.

TARIFAT INVESTUESE

Tarifa investuese (si në përqindje ashtu edhe në vlerë) për vitin 2022 dhe vitin 2021, sipas secilit fond që ka ngarkuar ndaj mjeteve të investuara të FKPK-së, paraqitet në tabelën në vijim. Detaje shtesë paraqiten në pasqyrat financiare (të bashkëngjitura) tek kapitulli i Mjeteve Pensionale.

		2022		2021
FONDET INVESTUESE	NORMA VJETORE	VLERA E TARIFAVE	NORMA VJETORE	VLERA E TARIFAVE
Vanguard – GSIF	0.18%	€45,340	0.18%	€222,373
BNY Mellon – RRF	0.54% - 0.63%	€1,482,878	0.60%	€2,169,117
AXA – GILB	0.40%	€5,918	0.35% - 0.40%	€209,240
Nordea 1 – GSEF	0.43%	€517,879	0.43%	€315,610
Nordea 1 – SRF	0.56%	€1,571,199	0.56%	€1,993,231
Amundi – 3M-I	0.057%	€52,364	0.045% - 0.057%	€49,957
BNP Paribas – PDP	0.76%	€56,979	0.55% - 0.76%	€357,745
S&P500 Minvol ETF	0.25%	€16,568	0.25%	€25,132
MSCI Minvol ETF	0.25%	€5,097	0.25%	€34,009
Invesco QQQ ETF	0.20%	€68,274	0.20%	€113,633
USCF US Oil ETF	0.45%	€100,315	0.45%	€109,543
Amundi MSCI Qual	0.23%	€45,405	0.23%	€121,140
FirstT CybrSec ETF	0.60%	€21,393	0.60%	€178,049
LG eCom Logst ETF	0.49%	€25,998	0.49%	€144,551
SP OilGas Expl ETF	0.35%	€166,432	0.35%	€37,429
Pacer Indust ETF	0.60%	€26,046	0.60%	€37,627
VG Real Estate ETF	0.12%	€7,254	0.12%	€20,028
Glob xUS Infr ETF	0.47%	€213,719	0.47%	€79,271
iShare US Infr ETF	0.40%	€186,056	0.40%	€65,279
Inv Bas Metals ETF	0.75%	€276,002	0.75%	€153,702
BNP Clim. Impact	0.885%	€21,206	0.499% - 0.885%	€13,184
T.Rowe Glob Tech	0.87%	€28,355	0.745% - 0.87%	€15,769
Amund CPR Disrupt	1.35%	€66,425	0.61% - 1.35%	€11,952
AXA Digital Econ	0.76%	€30,018	0.56% - 0.76%	€14,241
GS Millennials	0.88%	€31,795	0.73% - 0.88%	€8,353
Schroder ISF GSG	0.50%	€23,844	0.50%	€11,569
FirstT Green ETF	0.40%	€5,448	0.40%	€11,763
iSh. Glb Clean ETF	0.42%	€74,303	0.42%	€11,434
Invesco KBW Bank ETF	0.35%	€225,237	--	--
Lyxor USD 10Y Infl ETF	0.25%	€44,562	--	--
Lyxor EUR 10Y Infl ETF	0.25%	€136,202	--	--
Vanguard Value ETF	0.04%	€32,934	--	--
ISh MSCI Eur Value ETF	0.25%	€171,108	--	--
Global X Cybersecurity ETF	0.50%	€64,516	--	--
Lyx Stox Bank ETF	0.30%	€165,126	--	--
iShare Core Dividend ETF	0.08%	€19,345	--	--
SPDR EU Energy ETF	0.18%	€2,620	--	--
W.Tree Metals ETF	0.49%	€6,423	--	--
GJITHSEJ		€6,040,583		€6,534,931

85.5%
2022

85.2%
2021

SHPENZIMET OPERACIONALE

Shpenzimet operacionale¹⁾ përfshijnë të gjitha shpenzimet e tjera që nuk janë direkt shpenzime investuese e të cilat përbëhen prej kompensimeve, shtypjes dhe postimit të pasqyrave të llogarive, qirasë së zyrës, dhe shpenzimeve të tjera për operim.

Megjithatë, shpenzimet operacionale financojnë edhe të gjitha shpenzimet e anëtarëve të Bordit Drejtues, të cilët aktivitet kryesor e kanë vendimmarrjen për investimin e mjeteve pensionale.

Për vitin 2022 shpenzimet operacionale ishin €1,139,768 (2021: €1,191,245) dhe përbënin 14.5% të totalit të shpenzimeve të FKPK-së (2021: 14.8%) - kur llogariten edhe shpenzimet për investime. Siç mund të vërehet, shpenzimet operacionale ishin më të ulëta këtë vit (për 51,477 euro) sesa vitin e shkuar ose për -4.3% më pak.

Më 2022 buxheti i paraparë operacional për mallra dhe shërbime u realizua në masën prej 85.2% (2021: 85.0%).

Vlera e suficitit për vitin 2022 nga aktivitetet operacionale ishte në shumën prej €264,502. Këto mjete do të shkojnë për financimin e buxhetit operacional për vitin 2023 ose do të kthehen në fondin pensional.

Ulja e shpenzimeve operacionale këtë vit erdhi kryekëput nga shpenzimet për mirëmbajtje të softuerëve (me ulje prej 70%) dhe nga kostoja e stafit (me ulje prej 4%).

Tek mirëmbajtja softuerike shpenzimet u ulën për shkak se u vendos në përdorim IPSA dhe kështu nuk do të paguhet më për mirëmbajtje vjetore tek një operator tjetër ekonomik.

Tek Bordi Drejtues kishte rritje kryesisht për shkak të sigurimit fiduciar ku ka pasur rritje të primit.

Në anën tjetër, në vlerë nominale më së shumti u ngrit kategoria buxhetore e dërgimit të pasqyrave tek kontribuuesit, pastaj shpenzimet operative të zyrës dhe shpenzimet e trajnimit/udhëtimeve.

Linjat e tjera buxhetore nuk ndryshuan shumë krahasuar me vitin paraprak, duke bërë kështu që shpenzimet e përgjithshme operative të këtij viti të jenë më të ulëta në tetë vjetët e fundit.

Shifrat për secilën linjë buxhetore prezantohen në tabelën e faqes vijuese, ndërsa shpjegimet e detajuara në pasqyrat e bashkëngjitura financiare.




TABELA E SHPENZIMEVE OPERACIONALE

	2022		2021	
Kostoja e stafit	€625,155	54.8%	€653,595	54.9%
Shpenzimet për Bordit Drejtues	€132,658	11.6%	€128,592	10.8%
Zhvlerësimi dhe amortizimi	€118,771	10.4%	€111,869	9.4%
Pasqyrat e llogarive dhe korrespondencat	€98,519	8.6%	€86,520	7.3%
Shpenzimet operative të zyrës	€34,018	3.0%	€26,606	2.2%
Mirëmbajtja e softuerëve	€30,806	2.7%	€102,727	8.6%
Tarifa e mbikëqyrjes nga BQK	€20,070	1.8%	€21,024	1.8%
Shërbimet profesionale/Kontraktuesit/Konsulentët	€20,489	1.8%	€21,467	1.8%
Auditimi i jashtëm	€11,200	1.0%	€10,200	0.9%
Shpenzimet e interesit dhe qirasë	€10,005	0.9%	€11,046	0.9%
Trajnimet, udhëtimet dhe shpenzimet e tjera për stafin	€8,568	0.8%	€1,523	0.1%
Shpenzimet për komunikim	€6,232	0.5%	€6,849	0.6%
Edukimi publik dhe reklamat	€5,599	0.5%	€1,308	0.1%
Tarifat e bankave	€2,105	0.2%	€1,884	0.2%
Shpenzime të tjera	€15,573	1.4%	€6,035	0.5%
GJITHSEJ	€1,139,768	100%	€1,191,245	100%

1) Për më shumë informacione ju lutemi referojuni pasqyrave financiare të audituara, të cilat, sikurse kërkohet me Ligjin për Fondet Pensionale, përgatiten në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

02

AKTIVITETET

Bordi Drejtues - Menaxhmenti
Menaxhimi i llogarive
Barazimi i kontributeve
Shërbimi për klientë

AKTIVITETET E BORDIT DREJTUES

Angazhimi kryesor i Bordit Drejtues është vendimmarrja për investimin e mjeteve nën menaxhim. Në funksion të kësaj, në periudha të rregullta por edhe sipas nevojës, Bordi Drejtues ka vazhduar të ndërmarë vendime proaktive për t'ia përshtatur nivelin e riskut mjeteve pensionale të investuara, sipas parashikimeve për zhvillimet në tregjet financiare ndërkombëtare.

Përveç konfirmimit e përshtatjes periodike të limiteve ligjore investuese sipas instrumenteve financiare (në harmoni me Manualin e Investimeve), ishin rreth 70 vendime të Bordit Drejtues këtë vit, të konsultuara me menaxhmentin dhe stafin profesional të FKPK-së, rreth rialokimit të mjeteve pensionale. Këto vendime çuan në shtimin e 1.49 miliardë eurove në tregjet financiare dhe tërheqjen e 1.47 miliardë eurove në periudha të ndryshme të vitit.

Qysh në fillim të vitit 2022, sidomos për shkak të paralajmërimeve serioze për invazionin ushtarak të Rusisë në Ukrainë, Bordi Drejtues e uli ndjeshëm ekspozimin ndaj instrumenteve financiare me rrezik të lartë. Gjithashtu prej shkurtit 2022 për të gjithë kontribuuesit deri 18 muaj para pensionimit do të krijohej një portofol i ri investues (Konservativ), mjetet pensionale të cilëve do të investohen mbi 95% në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Ky vendim është korigjuar tutje prej 1 janarit 2023, duke i përfshirë në këtë portofol kontribuuesit që janë deri 24 muaj para daljes në pension. Këto vendime rezultuan mjaft të suksesshme, duke krijuar mbrojtje të kënaqshme të investimeve në tregjet ndërkombëtare, si dhe një kthim pozitiv prej rreth 3% për kontribuuesit e portofolit Konservativ.

AKTIVITETET E MENAXHMENTIT

Përveç dhënies së ndihmës për Bordin Drejtues dhe ekzekutimin e vendimeve të tij, Menaxhmenti siguron që të gjitha proceset ditore (operacionet) funksionojnë pa ndërprerje. Kjo nënkupton se të dhënat dhe informacionet për kontribuuesit janë të sigurta, se shërbimet ofrohen me standarde të larta profesionale dhe se përfituesit e pensionit i marrin pagesat në kohë.

Po ashtu sigurohet se raportet periodike, përfshirë raportin vjetor, përpilohen dhe iu dërgohen institucioneve mbikëqyrëse dhe Rregullatorit në kohë ose sa herë kërkohet; se transferimet e mjeteve pensionale drejt fondeve investuese dhe llogarisë së FKPK-së realizohen saktë; e se komunikimi me menaxhuesit e mjeteve dhe brokerët bëhet në standardet më të larta profesionale dhe përpikëri ligjore.

Njëkohësisht shërbimi online eTrusti, që ka tashmë mbi 300 mijë përdorues, si dhe uebfaqja e FKPK-së, duhet të jenë në dispozicion; që kontribuuesit të informohen për gjendjen e pasqyrës së llogarisë, e që komunikimi me publikun, dhe

Sa i përket investimeve në Kosovë, në fletobligacionet e Qeverisë së Kosovës dhe depozitat e bankave që operojnë në Kosovë, në fund të vitit 2022 i kishim 689.3 milionë euro ose rreth 153 milionë euro më shumë sesa vitin paraprak (2021: 536.0 milionë euro). Këtë vit kishim shtim të investimeve si në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës (me +62 milionë euro) por edhe më shumë në depozitat bankare të Kosovës (+92 milionë euro) sesa fundvitin 2021.

Përveç vendimeve rreth investimit të mjeteve pensionale, ndër aktivitetet e rëndësishme të Bordit Drejtues për vitin 2022 ishte edhe rishikimi e miratimi i buxhetit vjetor të FKPK-së, bashkë me propozimin e nivelit të tarifave menaxhuese për miratim në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu janë diskutuar dhe miratuar raportet e ndryshme të brendshme të FKPK-së (raportet tremujore të auditimit të brendshëm, raporti vjetor, raporti i performancës). Edhe të gjitha çështjet e dala nga Raporti Inspektues i BQK-së dhe Raporti i Auditorit të Jashtëm janë trajtuar në kohë.

Përveç çështjeve investuese dhe administrative, Bordi Drejtues ka zhvilluar takime të rregullta (dhe sipas kërkesës) me Bankën Qendrore të Kosovës dhe komisionet e rregullta të Kuvendit të Kosovës. Gjithashtu këtë vit kishim pjesëmarrje të anëtarëve të Bordit Drejtues në disa aktivitete ndërkombëtare, ku janë prezent edhe zyrtarët e menaxhuesve të fondeve pensionale.

palët e treta, të jetë aktiv çdo ditë pune, duke përjashtuar rastet e ndërprerjeve të planifikuara, që mund të jenë një herë në vit - për testimet e rregullta. Mbi të gjitha, duhet garantuar se të gjitha transaksionet financiare janë në përputhje të plotë me rregullat, ligjet dhe standardet (edhe ndërkombëtare) në fuqi, dhe se asnjë vendim ose veprim të mos jetë në kundërshtim me legjislacionin dhe/ose interesin e kontribuuesve.

Gjatë vitit Menaxhmenti ishte i fokusuar në: mbështetjen profesionale të Bordit në vendimmarrjen rreth investimeve (brenda e jashtë vendit); lansimin e projektit IPISA (për menaxhimin e llogarive të kontribuuesve); përgatitjen e portofolit të dytë (konservativ) për mbrojtjen e kontribuuesve afër pensionimit; avancimin e vazhdueshëm të teknologjisë së brendshme të informacionit dhe digjitalizimin e plotë të proceseve; dhe përmbyshjen e të gjitha kërkesave të BQK-së, auditorit të brendshëm dhe auditorit të jashtëm për gjithë zinxhirin operues të institucionit.

MENAXHIMI I LLOGARIVE

Më shumë se 576 mijë njoftime për gjendjen e llogarisë u dërguan me postë dhe e-mail.

Nga gjithsej 792,995 llogari që janë të hapura nga themelimi në FKPK, në ciklin e vitit 2022 janë dërguar 576,448 pasqyra, nga cilat 433,172 me e-mail dhe 143,276 me postë (2021: 415,788 me e-mail dhe 126,972 me postë).

Pra për vitin 2022 janë dërguar 33,688 pasqyra më shumë sesa vitin paraprak, nga të cilat 17,384 pasqyra më shumë janë dërguar me e-mail dhe 16,304 pasqyra më shumë me postë. Ndikimin kryesor në rritjen e numrit të pasqyrave të dërguara sivjet e kishte hapja e 40,409 llogarive të reja gjatë vitit 2022.

Sqarojmë këtu se nga lista e dërgimit të pasqyrave vjetore (pra prej gjithsej llogarive 792,995) përjashtohen këto raste: 1) pasqyrat e llogarimbajtësve që nuk kanë pasur asnjë transaksion në tri vjetët e fundit (siç është parashikuar me ligj); 2) pasqyrat e atyre që iu mungon adresa e vendbanimit (që për 2022 ishin 19,590 sosh - kundrejt 2021 që ishin 19,732); si dhe 3) atyre që janë në pensionim të përhershëm (pra pa përfshirë të pensionuarit e invaliditetit). Kjo kategori prej themelimit e deri në fundvitin 2022 arriti në 64,384 sosh. Por kësaj kategorie të kontribuuesve iu dërgohet njoftimi me postë para pensionimit (moshës 65 vjeçare).

Për këtë vit i kishim 4,851 punëdhënës dhe 3,687 të vetëpunësuar që i kishin paguar kontributet në vitin paraprak por jo më 2022 (2021 përkatësisht: 4,561 dhe 3,728).

Llogaritur në tërësi, për vitin 2022, ishin 4.61 mln transaksione të postuara në llogaritë e kontribuuesve dhe mbi 571 mijë në llogari të punëdhënësve (2021: 4.27 mln, përkatësisht 606 mijë).

Të përfshira në transaksionet e llogarive të punëdhënësve janë 63,303 raste (2021: 65,609) të refondimit të: a) kontributeve të paguara gabimisht ose mbipagesave; dhe b) gjobave në ATK. Për sqarim këtu, gjobat përbëhen nga gjobat dhe interesat që i ngarkon ATK-ja mbi punëdhënësit (dhe të vetëpunësuarit) për vonesë në pagesë apo mosdeklarim të saktë të kontributeve pensionale - dhe të cilat punëdhënësit i kanë paguar së bashku me kontributin pensional.

Këto transaksione refonduese në 99.6% e rasteve ishin mbipagesat (transaksionet) e bëra nga punëdhënësit gjatë të njëjtit vit, në këtë rast gjatë 2022-s.

Punëdhënësit mesatarisht kanë deklaruar dhe paguar për 9.62 muaj të 2022-s, me një ngritje të lehtë nga viti paraprak (2021: 9.51); dhe të vetëpunësuarit për 3.37 tremujor të 2022-s, e ngritur po ashtu nga viti paraprak (2021: 3.32).

FKPK-ja i hapi 40,409 llogari të reja individuale (2021: 45,275), duke e çuar numrin e përgjithshëm të llogarive të hapura qysh prej themelimit në 792,995. Nga llogaritë e reja të hapura gjatë vitit (pra nga 40,409) 38,152 prej tyre ishin për kontribuuesit nismëtarë, d.m.th. që filluan kontribuimin më 2022, kurse pjesa tjetër (2,257) ishin raste të kontributimit për vitet e mëhershme, për të cilat FKPK-ja e ka marrë qoftë pagesën qoftë informacionin më 2022.

Gjatë vitit ishin 43,183 punëdhënës dhe 27,380 të vetëpunësuar që kishin paguar kontribute për vitin e raportimit (2021: 39,496 dhe 27,407, përkatësisht). Pra kishim një rritje për kategorinë e punëdhënësve (me 9.3%) dhe ulje shumë të lehtë të të vetëpunësuarve (me -0.1%).

9.6

NUMRI MESATAR I MUJVE PËR TË CILËT PUNËDHËNËSIT KANË PAGUAR KONTRIBUTE

(2021: 9.5)

3.4

NUMRI MESATAR I TREMUJORËVE PËR TË CILËT TË VETËPUNËSUARIT KANË PAGUAR KONTRIBUTE

(2021: 3.3)



BARAZIMI I KONTRIBUTEVE

Në llogarinë e FKPK-së, së bashku me kontributet pensionale, paguhen edhe gjobat dhe interesat për mos-raportimin dhe mos-pagesën me kohë të kontributeve pensionale. Këto mjete i takojnë ATK-së andaj FKPK, në baza tremujore, në bashkëpunim me ATK-në, bën identifikimin dhe kthimin e tyre nga llogaria e FKPK-së në atë të ATK-së. Pas kthimit në ATK të mjeteve të pabarazuara, nëse FKPK-së i vjen informacioni se kujt i përkasin këto mjete, bëhet kthimi i tyre dhe alokimi në llogarinë përkatëse në FKPK.

Për shkak të gjobave dhe interesave të TM4 2022 (të cilat i përkasin ATK-së dhe të cilat pritet t'u kthehen në pjesën e parë të vitit 2023) dhe kryesisht kontributeve të paguara gjatë vitit 2022, e që ju përkasin viteve paraprake dhe që janë jashtë procesit të rregullt të deklarimit (EDI) të realizuara bashkë me kontributet pensionale në llogarinë e FKPK-së, mjetet e pabarazuara në vlerë nominale u ngritën në fund të këtij viti në €2,950,426 (2021: €2,320,470). Edhe në këtë rast në momentin që të gjitha raportet konfirmohen, FKPK-ja e inicion kthimin në ATK të mjeteve që nuk janë kontribute pensionale.

Sidoqoftë FKPK-ja kur kthen mjete në ATK, sigurohet se janë shterur mundësitë e gjetjes së informacionit, për disa arsye: punëdhënësit nuk i kanë përcjellur listat e punëtorëve për të cilët janë paguar këto kontribute ose i kanë paguar me të dhëna të gabuara, bizneset e kanë mbyllur ose ndryshuar aktivitetin, dhe/ose kanë paguar gabimisht tatimet e gjobat si kontribute pensionale.

Megjithatë, vlen ta rikujtojmë se kontributet e pabarazuara, të cilat janë më të vjetra se gjashtë vjet, sipas legjislacionit

Kontributet e pabarazuara ishin sa 0.12% e gjithsej kontributeve të arkëtuara nga themelimi.

në fuqi, kthehen në buxhetin e Kosovës. Ndërsa, pasi të bëhet transferimi i këtyre mjeteve, ligji në fuqi ia ka ruajtur kontribuuesve të drejtën që kurdo që sigurojnë informacione për këto kontribute, të njëjtit do të rimbursohen me vlerën e kontribuimit, duke i shtuar edhe mesataren e kthimit nga investimet e FKPK-së për periudhën nga momenti i pagesës e deri në datën e rimbursimit.

Bordi Drejtues dhe Menaxhmenti i FKPK-së vazhdojnë ta kenë në listë të angazhimeve barazimin e mjeteve për periudhat më të reja se gjashtë vjet, e sidomos për pagesat e vitit të fundit. Kështu edhe për vitin 2022 Bordi Drejtues e kishte vënë objektivin për mjetet e paalokuara, duke i dhënë këtij procesi vazhdim të vëmendjes në operacionet e përditshme të institucionit.



Duhet cekur këtu se përveç faktit se është përmirësuar dukshëm saktësia e raportimit të kontributeve pensionale (përmes portalit EDI në ATK), po ashtu vërehet se kontribuuesit gjithnjë e më shumë po kujdesen për gjendjen e kursimeve pensionale, duke reflektuar kështu rritje të vetëdijësisimit për rëndësinë e kontribuimit pensional.

Kujtojmë këtu se arsyet kryesore të mosbarazimit të kontributeve janë: (i) gjobat dhe interesat për pagesat e vonuara (ndaj ATK-së) përfshihen në pagesën e kontributeve; (ii) punëdhënësit e dërgojnë listën e pagesave por bëjnë nënpagesa ose mbipagesa të kontributeve; (iii) të dhënat për kontribuuesit në listë (numri personal ose emri) është i pavlefshëm; (iv) punëdhënësit i kryejnë pagesat e kontributeve por nuk e dërgojnë listën e detajuar për kë janë bërë; dhe (v) burimi i pagesës (punëdhënësi) nuk është i identifikuar.

Kontributet e pabarazuara si përqindje e gjithsej kontributeve të arkëtuara:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Kontributet e pabarazuara (të pa njësuara deri në datën e raportimit)	€2,950,426	€2,320,470
Kontributet kumulative të njësuara deri në datën e raportimit	€2,430,714,987	€2,189,252,434
Kontributet e pabarazuara si përqindje e kontributeve të njësuara deri në datën e raportimit	€0.121%	€0.106%

MJETET PENSIONALE NETO TË BARAZUARA NË LLOGARITË INDIVIDUALE



SHËRBIMI I KLIENTËVE

FKPK-ja e ka zyrën e vetme për shërbime në Prishtinë por shërbime pensionale ofrohen edhe nga gjashtë zyrat rajonale të ATK-së.

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës operon prej themelimit me një zyrë të vetme për shërbime, me seli në Prishtinë. Por shërbimet pensionale për: shtypjen e pasqyrës së llogarisë, aplikimin për pension dhe informim për kursimet pensionale ofrohen edhe në gjashtë zyrat rajonale të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Ky bashkëpunim i shkëlqyer institucional mes FKPK-së e ATK-së ka mundësuar shërbime në gjitha qendrat kryesore të vendit pa kosto shtesë për FKPK-në në punësim të stafit, pagesë për qira të zyrave rajonale dhe kosto të tjera operuese.

FKPK-ja i ofron shërbimet e veta në Prishtinë përmes angazhimit të gjashtë zyrtarëve pensionalë, një recepcionisti, një zyrtari të sigurisë dhe menaxherit të njësisë. Këtë vit, me ndryshimin e sistemit për menaxhimin e llogarive (tash IPSA) institucioni, e ka përditësuar edhe mënyrën e trajtimit të shërbimeve. Me ofrimin e mundësisë së marrje së pasqyrës së llogarisë nga portali shtetëror eKosova, tashmë shërbimi më i kërkuar (i marrjes së pasqyrës) është më i lehtë së asnjëherë më parë.

Sipas formatit të përditësuar, 391,828 kontribuues kanë kryer vetë ose kanë marrë shërbime nga portali eTrusti, portali eKosova, nga zyra e FKPK-së dhe nga zyrat rajonale të ATK-së në rajone.

Është tejet pozitive që tashmë shumica e kontribuuesve janë vetëshërbyer, duke marrë pasqyrën e llogarisë së tyre në FKPK përmes portalit eTrusti dhe eKosova. Nga 391,828 kontribuues prej tyre 62.4% (ose 244,402 kontribuues) kryen vetëshërbime në eTrusti (227,746 kontribuues) dhe në eKosova (16,656 kontribuues). Për shkak se në portalin eKosova shërbimi u lansua në javën e fundit të dhjetorit, efekti i plotë do të mund të matet në fund të vitit 2023, përkundër që shifrat janë mjaft inkurajuese.

Pjesa tjetër e shërbimeve u ofruan nga zyra e FKPK-së në 21.9% të shërbimeve gjithsej (ose për 85,783 kontribuues) dhe nga zyrat rajonale të ATK-së në 15.7% të shërbimeve gjithsej (ose për 61,643 kontribuues).

Shërbimi më i kërkuar edhe sivjet nga kontribuuesit ishte pasqyra e llogarisë. Pra 65.4% e të gjitha shërbimeve (që i kanë kryer vetë ose janë shërbyer) ishin për pasqyrën e llogarisë (ose për 256,397 raste). Krahasuar me vitin paraprak kemi pasur dyfishim të kësaj kërkesë, e nxitur nga diskutimi në Kuvendin e Kosovës për mundësinë e tërheqjes së parakohshme të deri 30% të bilancit të akumuluar në FKPK. Kjo krijoi pritshmëri dhe interesim shtesë tek kontribuuesit.

Dy shërbimet e tjera më të kërkuara sivjet ishin përditësimi i adresave të emaileve në eTrusti për 41,307 kontribuues (ose sa 10.5% e të gjitha shërbimeve), dhe autorizimi i qasjes në eTrusti për 41,193 kontribuues (ose sa 10.5% e të gjitha shërbimeve). Shërbime dukshëm më pak të preferuara ishin për përditësimin e adresave (sa 5.0% e shërbimeve), përditësimi i numrit të telefonit (sa 4.2% e shërbimeve), aplikimi për pension (sa 1.8% e shërbimeve) dhe pyetje e kërkesa (sa 0.7% e shërbimeve).

Përveç të gjitha shërbimeve që janë ofruar në zyrë, FKPK-ja i ka përgatitur dhe iu ka dërguar të gjithë kontribuuesve aktivë pasqyrat vjetore për 2022-shin. Nga gjithsej 792,995 llogari që janë të hapura nga themelimi në FKPK, në ciklin e vitit 2023 janë dërguar 576,448 pasqyra, nga cilat 433,172 me e-mail dhe 143,276 me postë (2021: 415,788 me e-mail dhe 126,972 me postë). Sipas legjislacionit në fuqi, jo të gjitha llogarive të hapura iu dërgohen pasqyrat vjetore.

Edhe për rastet e daljes në pension (që janë afër moshës 65 vjeçare) FKPK-ja iu dërgon rregullisht kontribuuesve letra me Postë; ku i informon për kohën e daljes në pension dhe për procedurat e aplikimit për tërheqjen e kursimeve pensionale nga FKPK-ja. Gjithashtu, duke filluar nga viti i kaluar, të gjithë kontribuuesit që e arrijnë moshën 63.5 vjeçare, dhe barten në Portofolin Konservativ, njoftohen paraprakisht për këtë lëvizje.


NUMRI I VETËSHËRBIMEVE NGA KONTRIBUESIT NË ETRUSTI

2022
227,746

NUMRI I SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA ZYRA E FKPK DHE ZYRAT E ATK - PËR INDIVIDËT DHE PUNËNËDHËNËSIT

2022
147,426

SHTIMI I NUMRIT TË LLOGARIVE NË eTRUSTI



#eTRUSTI është shërbim i bazuar në internet që ofrohet për të gjithë kontribuuesit prej vitit 2010.

Procedurat e regjistrimit kryhen përmes internetit, duke e verifikuar identitetin e kontribuuesit dhe konfirmuar e-mailin.


03

INVESTIMI I MJETEVE PENSIONALE

Parimet dhe politika e investimeve
Shpërndarja e mjeteve sipas investimeve
Shpërndarja gjeografike
Emetuesit kryesorë
Klasat e asetëve dhe valutat
Performanca e investimeve dhe krahasimi

{ Siguria e kursimeve pensionale; diversiteti i investimeve; maksimizimi i kthimit për nivelin e ndërmarrë të riskut dhe mirëmbajtja e likuiditetit adekuat janë bërthama e parimeve të matura investuese të FKPK-së }

LËVIZJA E ÇMIMIT TË NJËSISË E PORTOFOLIT STANDARD PREJ THEMELIT



LËVIZJA E ÇMIMIT TË NJËSISË E PORTOFOLIT KONSERVATIV PREJ THEMELIT



PARIMET DHE POLITIKA INVESTUESE

FKPK-ja vazhdoi t'iu përmbahet plotësisht Deklaratës së Parimeve dhe Politikave Investuese, baza e të cilave është vendosur më 2014. Kjo Deklaratë e ka përcaktuar Indeksin e Çmimeve të Konsumit të Kosovës si bençmark kundrejt së cilës do të matet performanca e investimeve të FKPK-së.

Udhëzuesi i Politikave Investuese (UPI), duke e pranuar që duhet të ketë një ekuilibër mes kontribuuesve që janë afër pensionimit dhe atyre që nuk janë, bën thirrje për një politikë e cila përmban një masë të arsyeshme por jo të tepruar të alokimit në mjete afatgjata, nga të cilat pritet kthim dhe luhatshmëri më e lartë, të tilla si aksionet; e kombinuar me një alokim më të madh në investime nga të cilat pritet luhatshmëri më e vogël dhe me kthime më të qëndrueshme sesa tek aksionet. Me këtë theks të rritur ndaj riskut, objektivi i UPI-t është të ofrojë më shumë mbrojtje kur tregjet janë në rënie, por megjithatë t'i korrë shpërblimet kur tregjet ngrihen.

Ndryshimi më i madh i politikës investuese të FKPK-së prej themelimit ishte këtë vit me lansimin e Portofolit Konservativ (për kontribuuesit e moshës 63.5 vjeçare), të cilët janë potencialisht më të rrezikuar nga gërryerja e kursimeve

të tyre pensionale prej lëvizjeve të shpejta rënëse të tregjeve financiare. Andaj mjetet e këtyre kontribuuesve do të llogariten të investuara kryesisht në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Dhe kjo zgjidhje dha rezultate tejet të kënaqshme, meqë çmimi i njësisë së këtij Portofoli u ngrit për 2.9%.

Ndërsa tek Portofoli Standard (për kontribuuesit e moshës nën 63.5 vjeç) politika investuese bazohet në një gërshetim të: a) klasave të asetëve - pra të instrumenteve financiare të investimeve direkte dhe atyre në kuadër të fondëve investuese; dhe b) strategjisë investuese të përvetësuar nga fondi investues. Në të gjitha këto pikëprerje të klasave të asetëve dhe strategjive ekzistojnë kufijtë e lejuar për t'u investuar në to.

Për vitin 2022 politika investuese, e përditësuar shpesh me veprime taktike, ka arritur të krijojë një mbrojtje të kënaqshme të portofolit investues - krahasuar me indekset kryesore të tregjeve financiare, që kishin rënie dyshifrore të vlerës për vitin 2022.

KLASA E ASSETIT	STRATEGJIA	ALOKIMI FAKTIK	KUFIJTË
Kesh dhe tregu i parasë	Të ardhura	17.2%	0%-50%
Instrumente borxhi në KS	Të ardhura	28.6%	0%-40%
Fletobligacione jashtë KS	Menaxhim risku	3.1%	0%-30%
Multi-asete	Menaxhim risku	17.6%	0%-55%
Asete reale	Drejtimore	6.2%	0%-20%
Aksione	Të ardhura	2.3%	0%-20%
Aksione	Menaxhim risku	7.0%	0%-20%
Aksione	Drejtimore	17.9%	0%-50%

Fondet e multi-asetëve nënkuptojnë fondet që në përbërje kanë edhe aksione edhe instrumente borxhi të shteteve dhe korporatave botërore. Këto fonde synojnë të zgjedhin aksione dhe instrumente borxhi me potencialin më të madh (të perceptuar) për të gjeneruar kthime pozitive, nën besimin se luhatshmëria më e ulët e instrumenteve të borxhit do të kundërpeshojë luhatshmërinë e aksioneve dhe do të zvogëlojë rrezikun e përgjithshëm.

Kur mendohet mbrojtja e strategjisë investuese, këto fonde ndryshojnë alokimin në aksione dhe obligacione edhe për të ulur nënseksione të riskut brenda secilës klasë të mjeteve. Ato, gjithashtu, mund të vendosin alokime përmes derivateve (siç janë futures - marrëveshje për ekzekutimin e instrumenteve financiare në të ardhmen, me një datë dhe çmim të përcaktuar), në mënyrë që të mbrohen nga tregjet që shkojnë në drejtim të padëshiruar.

Fondet që e përshtasin menaxhimin e riskut me shënjestrimin e tij, përcaktojnë një nivel risku për luhatshmërinë e portofolit investues dhe në baza të rregullta i rialokojnë mjetet për luhatshmërinë e pritshme me atë nivel të riskut të përcaktuar. Fondet me strategji dividendi në portofolin investues përzgjedhin vetëm aksione nga korporatat e qëndrueshme, të cilat rregullisht paguajnë dividend.

Me strategjinë "Të ardhura" bëhet fjalë për plasmane direkte në instrumente që paguajnë interes, si p.sh. depozitat bankare, aksione të caktuara dhe fletobligacione e Kosovës. Investimet në instrumente "Drejtimore" nuk kanë një element shoqërues të administrimit të rrezikut dhe përfaqësojnë një pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në rreziqet dhe përfitimet e tregjeve financiare.

Më lart janë ofruar informacionet se ku bëjnë pjesë secili prej plasmaneve të FKPK-së më 31 dhjetor 2022.

SHPËRNDARJA E MJETEVE SIPAS INVESTIMEVE

Në Portofolin Standard, në fund të vitit 2022 mjetet nën menaxhim, prej €2,332.7 mln, ishin të shpërndara si në vijim: €1,689.3 mln ishin të investuara në tregjet financiare ndërkombëtare përmes fondeve investuese (2021: €1,808.3 mln); €459.0 mln ishin të investuara në fletobligacione të Kosovës (2021: €491.5 mln); €136.5 mln ishin të afatizuara me bankat që operojnë në Kosovë (2021: €44.8 mln); ndërkaq €31.1 mln ishin në BQK të painvestuara (2021: €9.3 mln).

Ndërsa në Portofolin Konservativ, në fund të vitit 2022 ishin gjithsej €95,008,318 mjete nën menaxhim, të shpërndara: €94,010,868 në bono të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe €997,450 ishin kesh në banka.

Bordi Drejtues mbajti, përgjithësisht, edhe këtë vit pozicion mjaft mbrojtës, duke arritur që përmes Portofolit Konservativ t'i mbrojë të gjithë kontribuuesit afër pensionimit nga luhatjet e tregjeve financiare.

Shpërndarja e investimeve sipas instrumenteve, klasës dhe strategjisë më 31 dhjetor 2022 në Portofolin Standard

INVESTIMI	KLASA/STRATEGJIA	MJETET	PËRQINDJA
Obligacione të Kosovës	Instrumente borxhi/Të ardhura	€458,962,109	19.82%
Amundi 3M-I	Kesh/Të ardhura	€382,119,647	16.50%
Nordea SRF	Multi-asete/Risk i menaxhuar	€224,068,597	9.68%
BNY Mellon RRF	Multi-asete/Risk i menaxhuar	€200,172,086	8.64%
Nordea GSE	Aksione/Risk i menaxhuar	€148,462,915	6.41%
Depozita bankare në Kosovë	Instrumente borxhi/Të ardhura	€136,528,917	5.90%
Vanguard Value ETF	Aksione/Drejtime	€118,823,433	5.13%
ISH MSCI Eur Value ETF	Aksione/Drejtime	€79,301,062	3.42%
Lyxor EUR 10Y Infl ETF	Instrumente borxhi/Risk i menaxhuar	€75,868,822	3.28%
Invesco KBW Bank ETF	Aksione/Drejtime	€67,214,478	2.90%
iShare US Infr ETF	Asete reale/Drejtime	€60,062,495	2.59%
Glob xUS Infr ETF	Asete reale/Drejtime	€59,069,111	2.55%
SPDR S&P Oil & Gas	Aksione/Drejtime	€56,943,838	2.46%
iShare Core Dividend ETF	Aksione/Të ardhura	€55,544,738	2.40%
Lyx Stoxx Bank ETF	Aksione/Drejtime	€53,615,661	2.32%
W.Tree Metals ETF	Asete reale/Drejtime	€30,100,598	1.30%
SPDR EU Energy ETF	Aksione/Drejtime	€29,529,067	1.28%
iShare Glb ClnEnerg ETF	Aksione/Drejtime	€22,171,891	0.96%
iShare SP500 MinVol ETF	Aksione/Risk i menaxhuar	€21,339,112	0.92%
BNP Climate Impact	Aksione/Drejtime	€2,223,726	0.10%
Schroder ISF GSG	Aksione/Drejtime	€1,540,491	0.07%
Vanguard GSIF	Aksione/Drejtime	€1,078,243	0.05%
Mjetet në BQK (të painvestuara)	--	€31,133,021	1.34%
GJITHSEJ		€2,315,874,058	100.0%

Shënim: Detajet për secilin fond investues prezantohen në pasqyrat financiare në kapitujt aneks 7 dhe 8 të këtij raporti.

EVROPË
€1,510,176,612
62.61%

AMERIKË VERIORE
€774,159,661
32.10%

AZI
€53,500,800
2.22%

OQEANI
€10,706,904
0.44%

TË TJERA
€63,508,208
2.63%



Në **Portfolin Standard** mjetet pensionale investohen përmes fondeve të hapura që drejtohen nga menaxherët e këtyre fondeve në aksione, instrumente borxhi, para të gatshme dhe në instrumente të tjera financiare të korporatave botërore dhe të shteteve sovraane. Në fund të vitit FKPK-ja kishte investime direkte dhe indirekte në instrumente financiare të 1,988 emetuesve botërorë (2021: 2,099) në Portfolin Standard.

Në **Portfolin Konservativ** mjetet pensionale investohen drejtpërdrejt në fletobligacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes ankandave publike. Ky investim përbën 99% të investimeve të këtij portfoli; ndërsa pjesa tjetër e portfolit (prej 1%) mbahet në depozita bankare në Kosovë.

Nr.	SHTETI	PËRQINDJA	MJETET
1.	SHBA	30.58%	€737,530,020
2.	Kosovë	29.97%	€722,802,173
3.	Francë	10.71%	€258,388,122
4.	Britani e Madhe	5.51%	€132,984,302
5.	Gjermani	3.41%	€82,235,887
6.	Itali	2.74%	€66,129,740
7.	Spanjë	2.08%	€50,136,546
8.	Irlandë	1.51%	€36,467,309
9.	Suedi	1.10%	€26,514,881
10.	Danimarkë	1.07%	€25,857,278
11.	Luksemburg	1.04%	€25,197,586
12.	Holandë	1.02%	€24,706,529
13.	Japoni	0.91%	€21,851,877
14.	Zvicër	0.88%	€21,162,320
15.	Kanadë	0.83%	€20,135,488
16.	Finlandë	0.77%	€18,499,449
17.	Gërnsi	0.48%	€11,671,932
18.	Australi	0.44%	€10,533,851
19.	Norvegji	0.35%	€8,414,738
20.	Kinë	0.29%	€7,114,834
21.	Hong Kong	0.28%	€6,736,724
22.	Izrael	0.20%	€4,776,163
23.	Kore e Jugut	0.19%	€4,479,350
24.	Brazil	0.18%	€4,315,558
25.	Austri	0.16%	€3,904,868
26.	Indi	0.16%	€3,738,880
27.	Meksikë	0.13%	€3,102,331
28.	Belgjikë	0.12%	€2,934,021
29.	Portugali	0.10%	€2,437,127
30.	Singapor	0.09%	€2,186,828
31.	Gjersi	0.07%	€1,719,890
32.	Hungari	0.06%	€1,403,737
33.	Tajvan	0.05%	€1,281,772
34.	Tajlandë	0.03%	€694,499
35.	Afrikë e Jugut	0.02%	€551,805
36.	Indonezi	0.02%	€543,714
37.	Bermudë	0.01%	€315,789
38.	Zelanda e Re	0.01%	€173,053
39.	Jordani	0.00%	€96,160
40.	Të tjera*	2.42%	€58,325,055

SHËNIM: Në këto llogaritje nuk janë përfshirë paraja e gatshme dhe mjetet në BQK.

PLASMANET KRYESORE

Lista e 25 emetuesve kryesorë (prej gjithsej 1,988) prezantohet më poshtë. FKPK-ja ekspozohet ndaj këtyre emetuesve në mënyrë indirekte, përmes fondeve investuese, gjersa plasmanet në Thesarin e Republikës së Kosovës, depozitat me afat (në bankat lokale dhe ato ndërkombëtare) janë direkte. Në këtë listë nuk përfshihen investimet në fonde të përbashkëta ose tregun e parasë së gatshme.

Sikurse dallohet në tabelën në vijim, Thesar i Republikës së Kosovës ishte bindshëm plasmani më i madh në një entitet të vetëm. Sivjet është risi që investimet në thesarin e Francës janë të renditura si plasmani i dytë më i lartë, i ndjekur nga Gjermania.

Nr.	PLASMANI	MJETET (në milionë)	ALOKIMI KUNDREJT MJETEVE GJITHSEJ
1.	Thesari i Kosovës	€552.8	22.8%
2.	Thesari i Francës	€52.4	2.2%
3.	BKT Banka Kosovë	€39.8	1.3%
4.	Thesari i Gjermanisë	€35.5	1.5%
5.	PCB Banka Kosovë	€35.2	1.5%
6.	Groupe BPCE	€28.7	1.2%
7.	Groupe Credit Mutuel	€28.6	1.2%
8.	NLB Banka Kosovë	€27.2	1.1%
9.	Barclays PLC	€26.8	1.1%
10.	BNP Paribas SA	€25.9	1.1%
11.	Credit Agricole Group	€25.1	1.0%
12.	BEK Banka Kosovë	€24.7	1.0%
13.	Societe Generale SA	€24.3	1.0%
14.	Thesari i Italisë	€20.1	0.8%
15.	Shell PLC	€17.5	0.7%
16.	Intesa Sanpaolo SpA	€17.2	0.7%
17.	Microsoft Corp	€15.1	0.6%
18.	Johnson & Johnson	€14.9	0.6%
19.	UniCredit SpA	€14.3	0.6%
20.	Thesari i Spanjës	€13.6	0.6%
21.	Bank of America Corp	€13.5	0.6%
22.	Sanofi	€12.8	0.5%
23.	Thesari i SHBA-ve	€12.5	0.5%
24.	Coca-Cola Co	€12.1	0.5%
25.	Electricite de France SA	€11.7	0.5%

Në Thesarin e Republikës së Kosovës ishin të investuara 23% e të gjitha mjeteve.

Duhet kujtuar se kufizimet ligjore kërkojnë që FKPK-ja të mos i tejkalojë plasimet siç vijojnë: a) jo më shumë se 30% në Thesarin e Kosovës; b) jo më shumë se 20% e mjeteve në fletobligacione borxhi të një emetuesi të vetëm të vlerësuar me AA ose më lart; c) 10% në fletobligacione të vlerësuar me A ose më lart; d) 5% në fletobligacione të vlerësuar me BBB ose më ulët; e) jo më shumë se 5% e mjeteve në një emetues të vetëm për aksione; dhe f) deri 1% në fletobligacione të vlerësuar me BB+ ose më ulët.

FKPK-ja nuk i ka tejkalluar asnjë nga këta kufij për investimet në një emetues të vetëm më 31 dhjetor 2022.

KLASAT E ASETEVE

Në Portofolin Standard, në fund të vitit 2022 mjetet gjithsej prej €2,317,043,866 ishin të ndara sipas këtyre klasave të asetëve: në Instrumente borxhi ishin €672,529,530 ose sa 29.0% e mjeteve; në Aksione ishin €657,788,653 ose sa 28.4% e mjeteve; në Multi-asete ishin €424,240,683 ose sa 18.3% e mjeteve; në para të gashme (kesh) ishin €382,119,647 ose sa 16.5% e mjeteve dhe në Asete reale ishin €149,232,205 ose sa 6.4% e mjeteve. Ndërsa keshi në banka në këtë datë ishte €31,133,146 ose sa 1.3% e mjeteve.

Kurse në Portofolin Konservativ, në këtë datë mjetet prej €95,008,318 ishin të ndara në: Instrumente borxhi (obligacione të Kosovës) €94,010,868 ose sa 99.0% e mjeteve dhe keshi në banka €997,450 ose sa 1.0% e mjeteve.

Sikurse dallohet, tek dyja portofolet instrumenti me më së shumti investime ishte ai i Instrumenteve të borxhit, me përkatësisht 29.0% dhe 99.0%.

Bonot përbënin 33.4% e gjithsej mjeteve të investuara.

Ndërsa llogaritur së bashku, mjetet e investuara të FKPK-së, direkt dhe indirekt, për të dyja portofolet investuese (Standard dhe Konservativ) në fund të vitit kishin në përbërje 33.4% në instrumenteve të borxhit (2021: 33.2%).

Investimet në Kosovë, që këtu janë vetëm për investimet në letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkundër se nuk kanë rangim, vlerësohen de-facto nga ligji me siguri të lartë të kthimit nga investimi.

Sa i përket valutave, nga 20 fondet e angazhuar në datën e raportimit: (a) 11 ishin të denominuara në EUR, me shumën prej 1,217,778,938 EUR që përfaqësonin 50.2% të gjithsej mjeteve; dhe (b) 9 ishin të denominuara në USD, me shumën prej 471,471,073 EUR, që përfaqëson 19.4% të gjithsej mjeteve (2021: 17 fonde në EUR me shumë 1,541,952,506 EUR ose 65.1% e gjithsej mjeteve, dhe 8 fonde në USD me shumë 266,357,285 EUR ose 11.3% e gjithsej mjeteve).

REJTINGU I PLASMANEVE NË INSTRUMENTE TË BORXHIT DHE NË INSTRUMENTET INDIREKTE TË PARASË SË GATSHME

RISKU	REJTINGU	CILËSIA E PLASMANIT	INSTRUMENTE TË BORXHIT DHE PARAJA E GATSHME
	--	Investimet në Kosovë	23.4%
	--	Jashtë Kosovës	1.0%
	AAA	I dorës së parë	2.5%
	AA	I lartë	2.7%
	A	I mesëm i epërm	1.9%
	BBB	I mesëm i ulët	1.1%
	BB	I ulët	0.6%
	B	Me risk të moderuar	0.3%
	C dhe më i ulët	Me risk të lartë	0.0%

PERFORMANCA INVESTUESE

Në Portofolin Standard
investimet kishin kthim negativ prej €-121.5 mln ose
një rënie prej -5.5% për vitin 2022

Kthimi bruto i Portofolit Konservativ ishte
€2.7 mln ose një ngritje prej +2.9% për 2022

PLASMANI	ALOKIMI MË 31.12.2022	KTHIMI BRUTO PËR VITIN
Vanguard – GSIF (ISIN: IE00B03HD316)	€1,078,243	€(5,943,033)
BNY Mellon – RRF (ISIN: IE00B504KX99)	€200,172,086	€(33,876,321)
AXA – GILB (ISIN: LU0227145629)	--	€(393,667)
Nordea 1 – GSEF (ISIN: LU0257969260)	€148,462,915	€651,539
Nordea 1 – SRF (ISIN: LU0539147214)	€224,068,597	€(28,745,349)
Amundi – 3M-I (ISIN: FR000703813)	€382,119,647	€850,637
BNP Paribas – PDP (ISIN: LU0102035119)	--	€(3,354,516)
S&P500 Minvol ETF (ISIN: IE00BYX8XD24)	€21,339,112	€(366,785)
MSCI Minvol ETF (ISIN: IE00B86MWN23)	--	€(1,370,154)
Invesco QQQ ETF (ISIN: US46090E1038)	--	€(4,344,676)
USCF US Oil ETF (ISIN: US91232N2071)	--	€13,733,000
Amundi MSCI Qual (ISIN: LU1681041890)	--	€(10,561,869)
First Trust CybrSec ETF (ISIN: US33734X8469)	--	€(3,307,827)
LG eCom Logst ETF (ISIN: IE00BF0M6N54)	--	€(3,408,587)
SP OilGas Expl ETF (ISIN: US78468R5569)	€56,943,838	€7,091,647
Pacer Indust ETF (ISIN: US69374H7668)	--	€(5,281,034)
VG Real Estate ETF (ISIN: US9229085538)	--	€(5,745,840)
Glob xUS Infr ETF (ISIN: US37954Y6730)	€59,069,111	€(1,748,977)
iShare US Infr ETF (ISIN: US46435U7138)	€60,062,495	€788,192
Inv Bas Metals ETF (ISIN: US46140H7008)	--	€(795,250)
BNP Clim. Impact (ISIN: LU0406802768)	€2,223,726	€(3,054,986)
T. Rowe Glob Tech (ISIN: LU1244139827)	--	€(5,945,216)
Amund CPR Disrupt (ISIN: LU1530899811)	--	€(4,169,362)
AXA Digital Econ (ISIN: LU1694772994)	--	€(4,131,236)
GS Millennials (ISIN: LU1820776075)	--	€(5,078,584)
Schroder ISF GSG (ISIN: LU2305367323)	€1,540,491	€(2,410,877)
First Trust Green ETF (ISIN: US33733E5006)	--	€(4,554,511)
iSh. Glb Clean ETF (ISIN: US4642882249)	€22,171,891	€(2,381,583)
Invesco KBW Bank (ISIN: US46138E6288)	€67,214,478	€(16,738,885)
Lyxor USD 10Y Infl. (ISIN: LU1390062831)	--	€8,776,607
Lyxor EUR 10Y Infl. (ISIN: LU1390062245)	€75,868,822	€4,025,246
Vanguard Value ETF (ISIN: US9229087443)	€118,823,433	€2,552,270
iSh MSCI Eur Value (ISIN: IE00BQN1K901)	€79,301,062	€(4,818,494)
Global X CyberSec. (ISIN: US37954Y3844)	--	€(5,912,030)
Lyx Stoxx Bank (ISIN: LU1829219390)	€53,615,661	€(7,220,044)
iShare Core Dividend (ISIN: US46434V6213)	€55,544,738	€(1,246,330)
SPDR EU Energy (ISIN: IE00BKWQ0F09)	€29,529,067	€(456,939)
W.Tree Metals ETF (ISIN: GB00B15KYG56)	€30,100,598	€118,455
Fletobligacionet dhe depozitat bankare në Kosovë	€595,491,026	€11,558,584
Të ardhura të tjera - dividendat nga rivlerësimi i fondeve të hapura	--	€5,739,074
GJITHSEJ	€2,284,741,037	€(121,477,711)

Prej shkurtit 2022 FKPK-ja operon me dy portofole investuese: Portofolin Standard (për kontribuuesit e moshës nën 63.5 vjeçare) dhe Portofolin Konservativ (për kontribuuesit e moshës 63.5 vjeçare e lart). Për vitin 2022 performanca e Portofolit Standard ishte negative prej -5.5% ose me një kthim bruto prej -121.5 milionë euro. Përkundër se ishte negative, performanca e këtij portofoli ishte dukshëm më e mirë sesa e shumë indekseve dhe fondeve pensionale, që pësuan rënie dyshifrore për vitin 2022.

Ndërsa Portofoli Konservativ kishte rezultat pozitiv për këtë vit, me ngritje prej +2.9% ose kthim bruto prej 2.7 milionë euro. Kuptohet se investimet e këtij portofoli kanë vetëm qëllim mbrojtës. Për këtë arsye mjetet e kontribuuesve të kësaj grupmoshe ishin 99% të investuara në fletobligacionet e Qeverisë së Kosovës. Kthimi vjetor pritet të jetë me siguri shumë të lartë investuese. Ky portofol e ka eliminuar mundësinë që kontribuuesit afër pensionimit të goditen nga rëniat e shpejta dhe të forta të tregjeve.

PLASMANI	ALOKIMI MË 31.12.2022	KTHIMI BRUTO PËR VITIN
Fletobligacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës	€93,822,668	€2,728,766
Keshi në BQK	€997,450	--€9,643
Gjithsej	€94,820,118	€2,719,123

PERFORMANCA KUNDREJT BENÇMARKUT


Bordi Drejtues i FKPK-së e ka caktuar Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në Kosovë, të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, si cak (bençmark) për ta arritur dhe tejkaluar nga investimi i mjeteve pensionale.

Performanca negative e FKPK-së në Portofolin Standard për vitin 2022 (prej -5.5%) bashkë me një inflacion shumë të lartë këtë vit (prej 12.1%) bëri që inflacioni ta tejkalonte çmimin e njësisë së FKPK-së të Portofolit Standard në krahasim historik.

Bordi Drejtues beson se tejkalimi i këtij caku është kyç për ta mbajtur vëmendjen tek ruajtja e vlerës reale të kontributeve pensionale në afatgjatë.

Ndërsa çmimi i njësisë së FKPK-së ra në kuotën 62.68% nga themelimi, IÇK u ngrit në 66.36%.

KRAHASIMI I ÇMIMIT TË AKSIONIT TË FKPK-SË I PORTOFOLIT STANDARD DHE INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT NË KOSOVË (PREJ THEMELIMIT E DERI NË FUND TË 2022-S)



04

KONTRIBUIMI DHE PENSIONIMET

Fillimi dhe pasivizimi i kontribunit

Kontribumi

Kur dhe si mund të tërhiqen kursimet pensionale?

Pensionimet dhe pagesat e benefiteve

FILLIMI DHE PASIVIZIMI

Kontribuues aktivë FKPK-ja i quan personat që paguan kontribute për vitin e raportimit, në këtë rast për vitin 2022. Ndërsa kontribuues nismëtarë FKPK-ja i quan ata kontribuues aktivë, 11.5% e mesatares së kontribuuesve aktivë të këtij viti, që për herë të parë paguan kontribute në dhe për vitin 2022 (2021: 10.3%).

Kontribuuesit nismëtarë numëronin gjithsej 38,152 veta ndërsa ishin 8,538 të tjerë (2021: 16,647), ose 2.6% (2021: 4.0%) e mesatares së kontribuuesve aktivë, të cilët pushuan sivjet (kontribuan më 2021 por jo më 2022); dhe në këtë numër nuk janë përfshirë 6,907 llogari të pensionuar përherë në vitin 2022.

Ndërkaq, 13.6% e kontribuuesve nismëtarë më 2022 u punësuan⁽¹⁾ për herë të parë në moshën 40+ vjeçare (2021: 11.8%), që është një ngritje prej gati dy pikësh përqindjeje nga viti kaluar.

Mosha mesatare e kontribuuesve nismëtarë më 2022 ishte 26.4 vjeç, gjersa 62.8% e tyre ishin 25 vjeç ose më të rinj (2021: përkatësisht 26 dhe 68% e tyre ishin 25 vjeç ose më të rinj).

Të vetëpunësuarit, që përbënin rreth 1.8% të kontribuuesve nismëtarë (2021: 1.8%), vazhduan të jenë në mesatare më të moshuar. Mosha e tyre mesatare ishte 34.5 vjeç, dhe 52.4% e tyre ishin 33 vjeç ose më të rinj.

Pjesa e femrave nismëtare ishte 51.1% për të punësuarat (2021: 52.5%); dhe 33.9% (2021: 34.4%) për të vetëpunësuarat.

Kontributet e arkëtuara vjetore u ngritën për 13.1% ndërsa pagesa e pensioneve e u ngrit për 3.8%.

Në anën tjetër, femrat u pasivizuan edhe këtë vit në norma më të ulëta sesa që po nisin të kontribuojnë, duke përbërë kështu 43.3% nga të punësuarit dhe 21.1% nga të vetëpunësuarit që u pasivizuan (2021: 41.5% dhe 27.3%, përkatësisht), por pak më shumë sesa vitin paraprak. Ky është një tregues që femrat kishin stabilitet më të lartë në punësim.

Pasivizimi i kontribuuesve edhe këtë vit më së shumti iu ndodhi grupmoshave 21-26 vjeç (2021: 19-25 vjeç). Më tej, 50% e kontribuuesve të 2022-s, që ishin pasiv gjatë vitit, ishin 30 vjeç ose më të rinj tek të punësuarit dhe 43 vjeç ose më të rinj tek të vetëpunësuarit (2021: 50% e kontribuuesve 27 vjeç; 39 vjeç, përkatësisht).

Përqindja e kontribuuesve (duke përfshirë të vetëpunësuarit) që janë bërë pasivë më 2021 por që u rikthyen në skemën e kontribuimit më 2022 kërceu ndjeshëm në 21.5%, krahasuar me vitin 2021 kur numri i kontribuuesve të pasivizuar më 2020 që ishin rikthyer në skemë më 2021 ishte vetëm 5.7% e tyre.

Analizimi i të dhënave për pesë vjetët e fundit nxjerr në pah se 225,142 kontribuues të punësuar, dhe 18,295 kontribuues të vetëpunësuar, kanë kontribuar së paku një muaj në secilin nga këto pesë vjet (2021: 214,974 dhe 18,597). Pra ndërsa kontribuuesit punëmarrës kanë shtuar stabilitetin e kontribuimit pesë-vjeçar, kontribuuesit e vetëpunësuar shfaqin shenja jostabiliteti.

KONTRIBUIMI

Janë €2,430.7 mln kontribute të arkëtuara prej themelimit

Kontributet e arkëtuara këtë vit arritën në €241.5 mln (2021: €213.5 mln), që ishin pagesa të kontributeve pensionale të punëmarrësve dhe të të vetëpunësuarve.

Kontributet e arkëtuara gjatë 2022-s u rritën për 13.1% krahasuar me vitin paraprak. Më 2021 ato ishin rritur për 9.8% ndërsa më 2020 me 4.1%. Kontributet që nuk janë nën menaxhim, kuptohet se janë të tërhequra me rastin e pagesave të pensioneve ose refondimeve dhe më nuk janë pjesë e fondit.

Punëdhënës të rinj sivjet i kishim 6,226, duke qenë kështu një ngritje prej 9.2% nga viti paraprak (2021: 5,701). Punëdhënës të rinj konsiderohen bizneset, institucionet e tyre, të cilat për herë të parë kontribuojnë për punonjësit e tyre.

Ndërsa e kishim këtë vit një ngritje solide të punëdhënësve të rinj për 2022, megjithatë këtë rezultun se njëkohësisht kishim edhe 8.0% më shumë punëdhënës të pasivizuar, duke

shkuar kështu në 5,011 numri i punëdhënësve të pasivizuar (2021: 4,639). Andaj rezultun se diferenca e punëdhënësve të rinj kundrejt atyre të pasivizuar është me vetëm 1.2 pikë përqindjeje.

Punëdhënës që pasivizohen FKPK-ja i konsideron bizneset ose institucionet ose organizatat të cilat kanë kontribuar për punonjësit gjatë vitit paraprak por jo edhe në vitin e raportimit.

Në anën tjetër, numri i kontribuuesve aktivë në mesatare gjatë vitit 2022 arriti në 331,555, që ishte kështu për 5.0% më i lartë në mesatare sesa viti i shkuar (2021: 315,722).

Në fund të vitit, bilanci mesatar për të gjitha llogaritë e kursimeve pensionale të kontribuuesve u ul për 13.0% dhe ra në €3,412 (2021: €3,921). Performanca negative nga investimet më 2022 është faktori kryesor këtu, por ndikim gjithsesi pati edhe tërheqja e hershme përmes 10%-shit.

KONTRIBUTET E ARKËTUARA DHE NËN MENAXHIM

PERIUDHA	KONTRIBUTET E ARKËTUARA (në milionë)	KONTRIBUTET NËN MENAXHIM (LËVIZJET NETO VJETORE) (në milionë)
2002-2018	€1,594.8	€1,681.1
2019	€186.6	€285.8
2020	€194.4	€21.1
2021	€213.4	€365.1
2022	€241.5	€73.5
KUMULATIVE	€2,430.7	€2,426.6

MJETET NETO NËN MENAXHIM - PËRBËRJA

2022

KONTRIBUTE NËN MENAXHIM



FITIME



2021

KONTRIBUTE NËN MENAXHIM



FITIME



(1)

Termi "Punësim" është përdorur në kontekstin më të gjerë të mundshëm. FKPK-ja nuk është në pozitë të dijë nëse kontributet e nismëtarëve janë vërtetë si rrjedhojë e punësimit të tyre të parë. Për më tepër, FKPK-ja nuk mund të dijë nëse ai punësim është i përhershëm, me afat, apo për një punë të caktuar (kontratë mbi vepër).

PENSIONIMET DHE PAGESAT

Fitimi i realizuar nga e gjithë vlera e tërhequr për pensione më 2022 ishte 25.7% - rekord i ri vjetor.

Gjatë vitit 2022 FKPK-ja ka shpague pensione për arsye të moshës (65 vjeçare), për arsye të invaliditetit (sipas vendimit të Ministrisë kompetente) dhe për arsye të vdekjes (të trashëguar nga familjarët). Ndërsa tërheqjen e mjeteve nga FKPK-ja (sipas legjislacionit në fuqi) e kanë bërë edhe shtetasit e huaj (që nuk ishin të obliguar t'i paguanin kursimet pensionale në FKPK).

Fondet që u shpague për këto kategori të pensioneve për gjithë vitin 2022 ishin në vlerë prej 54.9 milionë euro gjithsej (2021: 65.5 milionë euro gjithsej). Arsyeja e vlerës më të ulët të shpagimit për pensione këtë vit ishte sepse më 2021 u shpague rreth 12.6 milionë euro për tërheqjen e hershme të 10%-shit (sipas ndryshimeve ligjore të vitit 2020).

Nga shuma e tërhequr për 2022 (54.9 milionë euro) 40.8 milionë euro ishin pjesa e kontributeve që i kishin paguar kontribuuesit, ndërsa 14.1 milionë euro ishin fitime të realizuara nga investimi i mjeteve pensionale. Kështu përqindja mesatare e fitimeve të realizuara më 2022 është 25.7% e gjithsej shpagimeve (2021: 24.6%).

Për të gjitha rastet e pensionimit më 2022 i kishim 6,907 llogari (2021: 7,239 llogari). Bashkë me llogaritë e

pensionuara me tërheqje të përhershme sivjet, numri i llogarive me tërheqje të përhershme nga themelimi shkon në 67,229.

Numri i personave që më 2022 u shpague pasi arritën moshën e pensionimit (65 vjeçare) ishte 5,124 ose 74.2% e aplikacioneve të miratuara (2021: 5,250, ose 72.5%).

Për arsye të invaliditetit 779 persona, 11.3% e krejt numrit, i tërhoqën kursimet pensionale (2021: 695 ose 9.6%).

Për rastet e vdekjes para pensionimit ishin 945 ose 13.7% tërheqje nga trashëgimtarët (2021: 1,196 ose 16.5%).

Kontribuuesit, me status shtetas jo-rezidentë të Kosovës, që i tërhoqën kursimet pensionale sivjet ishin 59 raste ose sa 0.9% e llogarive të pensionuara (2021: 98 raste dhe 1.4%).

Prej themelimit e deri në fund të vitit 2022 janë të tërhequr gjithsej 558.8 milionë euro. Nga kjo shumë e tërhequr 449.6 milionë euro ishin kontribute të akumuluar nga kontribuuesit (përmes pagesave mujore) dhe 109.3 milionë euro ishin fitime të realizuara nga investimet. Pra, nga gjithë shuma e tërhequr për pensione (prej themelimit të FKPK-së) kontribuuesit kanë realizuar mesatarisht 19.6% fitime.

KUR DHE SI MUND TË TËRHIQEN KURSIMET PENSIONALE?

Sipas legjislacionit në fuqi, që edhe për vitin 2022 nuk ka pësuar ndonjë ndryshim, kursimet pensionale mund të tërhiqen nga FKPK-ja nga kontribuuesi ose trashëgimtari në këto raste:

- Kur arrihet moshja e pensionit (aktualisht me ligj është caktuar moshja 65 vjeçare);
- Kur ka certifikatë invaliditeti nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- Kur vdes para pensionimit, e që në këtë rast trashëgimtarët ligjor të tij/saj e tërheqin gjithë bilancin e kursyer;
- Në rastet kur shtetasit e huaj kanë paguar kontribute pensionale, duke mos qenë të obliguar ligjërisht t'i paguajnë në FKPK.

SI MUND TË TËRHIQEN KURSIMET?

Programi i Tërheqjes në Faza (PTF)

PTF është i tillë që përfituesit në këtë skemë tërheqin nga kursimet e tyre çdo muaj nga €200¹⁾ ose 1% të bilancit në momentin e pensionimit (varësisht prej bilancit: deri 20 mijë euro bilanc nga 200 euro dhe mbi 20 mijë euro nga 1%), derisa i gjithë bilanci të shterojë.

Përfituesit mund të zgjedhin njëerën nga pesë bankat që ofrojnë shërbimin PTF: TEB, NLB Prishtina, Banka për

Biznese, Banka Ekonomike ose Banka Kombëtare Tregtare (BKT), duke përfituar kështu nga një trajtim specifik, sipas kontratës së FKPK-së me këto banka. Kontribuuesit që i tërheqin kursimet pasi arrijnë moshën e pensionit zgjedhin të marrin 0% ose 20% të kursimeve në një pagesë dhe shuma tjetër iu drejtohet në PTF.

Programi i Tërheqjes së Menjëhershme

Nëse një kontribuues ka bilanc në llogari më pak se €3,000¹⁾ kursime pensionale atëherë e gjitha shuma tërhiqet me një pagesë të vetme.

Tërheqjet e tjera (invaliditeti dhe rastet e vdekjes)

Kontribuuesit që i tërheqin mjetet për shkak të invaliditetit do t'i marrin kursimet e tyre përmes programit PTF në shumë prej €200¹⁾ deri në: i) periudhën që u mbaron invaliditeti; ose ii) derisa kursimet e tyre shterojnë - cilado që ndodhë e para. Në anën tjetër, përfituesit e kontribuuesve të vdekur mund të zgjedhin që t'i tërheqin të gjitha kursimet menjëherë ose t'i transferojnë ato në llogarinë e tyre të kursimeve pensionale në FKPK.

Për secilin rast të tërheqjes, ato i nënshtrohen tatimit në të ardhura, sipas legjislacionit në fuqi.

¹⁾ Tërheqja minimale mujore dhe pragjet e tërheqjes përcaktohen nga Rregulloret e BQK-së.

TËRHEQJET

PERIUDHA	KONTRIBUTET E PAGUARA (në milionë)	FITIMI I REALIZUAR (në milionë)	MJETET E TËRHEQURA (në milionë)	PËRQINDJA E FITIMIT
2004-2017	€104.1	€15.5	€119.5	13.0%
2018	€24.8	€6.5	€31.3	20.8%
2019	€41.9	€10.7	€52.6	20.3%
2020*	€188.6	€46.4	€235.0	19.7%
2021*	€49.4	€16.1	€65.5	24.6%
2022	€40.8	€14.1	€54.9	25.7%
GJITHSEJ	€449.6	€109.3	€558.8	19.6%

*E përfshijnë shumën e tërheqjeve të hershme përmes 10%-shit (sipas legjislacionit të ndryshuar).

Tërheqja e kursimeve pensionale për shtetasit e huaj

Tërheqjen e kursimeve pensionale nga FKPK-ja (sipas ligjit Nr. 04/L-101) mund ta bëjnë të gjithë shtetasit e huaj që nuk kanë qenë dhe nuk janë të obliguar të paguanin kursime pensionale në FKPK (përfshijtur shtetasit e vendeve me të cilat Kosova ka marrëveshje bilaterale ndryshe). Në rastin e shtetasve të huaj tërheqja bëhet për gjithë bilancin e akumuluar dhe menjëherë.

DEMOGRAFIA E KONTRIBUESVE

Kontribuuesit

Shpërndarja gjeografike e kontribuuesve

Mosha e kontribuuesve

Kontribuuesit sipas llojit të ndërmarrjeve

Kontribuimi mesatar

Niveli i kontribuimit

“Sa duhet të kurseni?”

KONTRIBUIMI AKTIV

Ky kapitull i përmbledh të dhënat kryesore demografike për kontribuuesit e FKPK-së më 2022 dhe i bën krahasimet me vitin paraprak.

Duhet pasur parasysh se ky kapitull i paraqet rezultatet e analizave për të gjitha llogaritë, që më 2022 arriti 792,995 (2021: 752,586 llogari) por edhe për llogaritë aktive, që më 2022 mesatarisht ishin 331,555 (2021: 315,722 mesatarisht). Në numrin e llogarive gjithsej përfshihen edhe llogaritë e pensionuara përherë (si pension moshe dhe raste të vdekjes). Ky numër në fund të vitit 2022 arriti në 67,229 llogari të pensionuara përherë.

Numri i kontribuuesve aktivë paraqitet për çdo muaj në pesë vjetët e fundit (në tabelën e faqes vijuese) si dhe mesatarja vjetore për secilin vit. Numri i kontribuuesve për çdo muaj paraqet angazhimin e kontribuuesve secilin muaj dhe nuk është kumulativ. Nga të dhënat mujore vihet re se fundi i tremujorit është gjithnjë me numër më të lartë të kontribuuesve. Kjo ndodh ngase të vetëpunësuarit bëjnë raportime dhe pagesa për tremujor dhe jo çdo muaj, sikur të punësuarit, andaj edhe ndodh ky ndryshim.

Këtë vit mesatarisht ishin 331,555 kontribuues aktivë (2021: 315,722). Me së paku një kontribut si punonjës gjatë vitit shfaqen 402,187 dhe si të vetëpunësuar 22,026; në këto shifra të numëruar dy herë janë 4,674 kontribuues, të cilët shfaqen gjatë 2022-s edhe si të punësuar edhe si të vetëpunësuar (2021 përkatësisht: 392,974, 21,604 dhe 5,073).

Përveç për muajin dhjetor 2022, që kishim më pak kontribuues aktivë, në të gjithë muajt e tjerë sivjet kishim më shumë kontribuues aktivë sesa në muajt përkatës të vitit 2021. Megjithatë, përkundër se për vitin 2022 ishin mbi 40 mijë llogari të reja (2021: mbi 45 mijë llogari të reja), në mesatare numri i kontribuuesve aktivë për vitin 2022 është për 15,833 (2021: 16,877) më i lartë sesa vitin paraprak.

Bilanci mesatar i llogarive aktive në fund të vitit 2022 u ul në €4,888 (2021: €5,412), ose me një rënie prej -9.7%. Rënia e bilancit mesatar ka ardhur për shkak të rënies së vlerës mjeteve pensionale nga investimet por edhe me rritjen e llogarive të reja që kanë pak kontribute të akumuluar. Këto bilance (në mesatare) janë të ulëta për të siguruar një pensionim të sigurt, meqë mund të financojnë (nëse tërhiqen në faza nga 200 euro në muaj) për vetëm 29 muaj për llogaritë aktive (sipas gjendjes aktuale).

Në nivelin relativisht të ulët të bilancit mesatar të të gjitha llogarive ndikon fakti që numri i të gjitha llogarive me bilanc të ulët është mjaft i madh. Po ashtu numri i atyre kontribuuesve që janë në skemë nga fillimi ose kanë kontribute të vazhdueshme me pagë mesatare është i ulët. Ndikim tjetër ka pasur edhe pjesëmarrja dhe kontribuimi mesatar shumë i ulët, posaqërisht në 10 vjeçarin e parë.

Është me rëndësi të bëhen edhe disa krahasime mes numrit të popullsisë aktive për punë në Kosovë dhe kontribuuesve aktivë në FKPK. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në raportin e Anketës së Fuqisë Punëtore për vitin 2021, popullsia në moshe pune në vend (e moshës 15 deri 64 vjeç) është 1,231,695. Ndërsa fuqia aktive për punë (po sipas ASK) llogaritet 483,465, e pjesa tjetër llogaritet si pasive.

Nën këto kushte, rezultojnë se 331,555 punëmarrës dhe të vetëpunësuar (me vlerësimin e mesatarës së angazhimit vjetor) që kontribuan në FKPK gjatë 2022-s përbëjnë 68.6% të fuqisë aktive (483,465) për punë. Ky numër megjithatë është ende tejet i ulët për të synuar që në afatgjatë qytetarët e Kosovës të kenë kursime pensionale të mjaftueshme në FKPK për moshën pas pensionimit.

Megjithëse vitet e fundit kemi një shtim të dukshëm të llogarive të reja të hapura për kontribuuesit në FKPK, ende përqindja e kontribuuesve aktivë (ndaj fuqisë aktive për punë) si dhe bilanci mesatar i llogarive në FKPK është larg të qenit i mjaftueshëm për një pension të dinjitetshëm.

FKPK-ja po i thekson, dhe përsërit, këto fakte duke besuar se kështu po e përmbush një pjesë të përgjegjësisë sociale që ka: që secili shtetas i Kosovës do të duhej të ketë kursyer mjaftueshëm për pensionin e vet, që do t'i mundësojë një jetë më të sigurt, në kuptimin financiar. Në të kundërtën, me këtë trend të kontribimit, nuk mund të planifikohet që shumica e të punësuarve të sotëm do të mund të kenë pension dinjitoz nga kursimet pensionale në FKPK dhe kështu rrezikojnë të vazhdojnë të jenë barrë për shtetin dhe/ose shoqërinë.

NUMRI I KONTRIBUESVE AKTIVË PËR ÇDO MUAJ NË PESË VJETËT E FUNDIT

	2022	2021	2020	2019	2018
JANAR	315,905	291,571	278,915	265,810	254,268
SHKURT	317,639	296,573	281,309	271,033	256,465
MARS	344,748	330,988	333,976	296,655	282,113
PRILL	328,814	303,679	321,387	277,462	263,754
MAJ	330,856	306,769	258,718	279,096	265,939
QERSHOR	353,434	328,749	304,820	303,988	291,169
KORRIK	332,154	312,725	287,817	284,046	269,660
GUSHT	331,105	311,886	289,344	284,911	269,993
SHTATOR	351,045	332,912	313,612	308,340	294,384
TETOR	330,169	324,599	298,224	294,570	271,550
NËNTOR	321,635	320,014	298,792	290,682	272,332
DHJETOR	321,150	328,195	319,225	307,393	293,741
MESATARJA VJETORE	331,555	315,722	298,845	288,666	273,781

SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE


Meqë një pjesë e madhe e kontribuuesve aktivë (rreth 20% e tyre) paguhen nga Ministria e Administratës Publike, zyra e së cilës është e regjistruar në Prishtinë, dhe meqë nuk kemi informacione të tjera përveç atyre ku punëdhënësi është i regjistruar, nuk e kemi të mundur të bëjmë analiza mbi atë se ku kanë punuar kontribuuesit gjatë vitit. Kjo është arsyeja përse FKPK-ja i prezanton vetëm analizat e bazuara sipas adresave të kontribuuesve nëpër komuna që FKPK-ja i ka në regjistrat e saj, dhe nuk e ka të mundur t'i përdorë të dhënat e tjera të zonës gjeografike.

Për vitin 2022 i kishim 23 komuna me shtim të numrit të kontribuuesve dhe në 15 komuna rënie të numrit të kontribuuesve aktivë. Përveç efektit të zgjedhjeve, që ishin më 2021, që ndikon në rritjen e kontribuuesve (përmes

angazhimit të stafit shtesë për organizimin dhe mbikëqyrjen e procesit zgjedhor), më 2022 kemi rënie të theksuar të kontribuuesve aktivë në disa komuna të rëndësishme, siç është rasti i Gjilanit dhe Gjakovës.

Gjithashtu në shumicën e komunave të dominuara nga komuniteti serb, kishim rënie të numrit të kontribuuesve aktivë, që ka të ngjarë të ketë ndodhur për shkak të largimit vullnetarë të një numri të madh të të punësuarve të këtij komuniteti në institucionet e Republikës së Kosovës.

Ndër komunat me numër më të lartë të kontribuuesve me shtim më të lartë të numrit të kontribuuesve aktivë ishin në Mitrovicë të Jugut (+12.2%), në Lipjan (+5.6%) në Fushë Kosovë (+4.6%) dhe në Ferizaj (+4.1%).



NR.	KOMUNA	NR. KONTRIBUESVE	PJESËMARRJA	NDRYSHIMI ME 2021	
				NË NUMËR	NË %
1.	PRISHTINË	77,067	18.0%	1,354	1.8%
2.	PRIZREN	34,830	8.1%	365	1.1%
3.	FERIZAJ	27,230	6.3%	1,083	4.1%
4.	PEJË	23,735	5.5%	727	3.2%
5.	GJAKOVË	23,019	5.4%	(142)	-0.6%
6.	GJILAN	22,778	5.3%	(1,050)	-4.4%
7.	PODUJEVË	20,850	4.9%	652	3.2%
8.	MITROVICË E JUGUT	18,909	4.4%	2,054	12.2%
9.	VUSHTRRI	17,555	4.1%	392	2.3%
10.	LIPJAN	15,080	3.5%	799	5.6%
11.	DRENAS	14,059	3.3%	342	2.5%
12.	FUSHË KOSOVË	12,020	2.8%	526	4.6%
13.	SUHAREKË	11,763	2.7%	54	0.5%
14.	SKËNDERAJ	11,248	2.6%	163	1.5%
15.	RAHOVEC	9,383	2.2%	(175)	-1.8%
16.	ISTOG	8,853	2.1%	243	2.8%
17.	MALISHEVË	8,790	2.0%	(22)	-0.2%
18.	VITI	8,511	2.0%	(99)	0.2%
19.	KAMENICË	7,081	1.7%	144	2.1%
20.	KLINË	7,023	1.6%	(139)	-1.9%
21.	KAÇANIK	6,713	1.6%	(125)	-1.8%
22.	OBILIQ	6,654	1.6%	51	0.8%
23.	DEÇAN	6,263	1.5%	87	1.4%
24.	SHTIME	5,885	1.4%	184	3.2%
25.	DRAGASH	4,474	1.0%	(317)	-6.6%
26.	GRAÇANICË	2,156	0.5%	(241)	-10.1%
27.	LEPOSAVIQ	1,939	0.5%	399	25.9%
28.	SHTËRPCË	1,798	0.4%	42	2.4%
29.	PARTESH	1,725	0.4%	1,331	337.8%
30.	HANI I ELEZIT	1,273	0.3%	(405)	-24.1%
31.	ZVEÇAN	1,137	0.3%	216	23.5%
32.	ZUBIN POTOK	972	0.2%	(125)	-11.4%
33.	NOVOBËRDË	684	0.2%	24	3.6%
34.	JUNIK	674	0.2%	(36)	-5.1%
35.	MAMUSHË	638	0.1%	(34)	-5.1%
36.	MITROVICË E VERIUT	449	0.1%	(1,089)	-70.8%
37.	KLLOKOT	402	0.1%	(180)	-30.9%
38.	RANILLUG	329	0.1%	(221)	-40.2%
	TË TJERË*	4,942	1.2%	2,285	86.0%

*Ky është numri i kontribuuesve me vendbanim jashtë Kosovës ose për të cilët FKPK-ja nuk kishte informacion se cilës komunë i takojnë.

MOSHA E KONTRIBUESVE

Mosha mesatare e të gjithë kontribuuesve në vitin 2022 u ngrit lehtë në 41.2 vjeç nga 41.0 sa ishte fundvitin paraprak.

Ndërsa mediana e të gjithë kontribuuesve nuk ndryshoi - ngeli 39 vjeç edhe për vitin 2022.

MESATARJA MESHKUJ:

43.2



MEDIANA MESHKUJ:

41.0



Mosha mesatare sipas gjinisë njohu lëvizje të lehtë. Për meshkujt arriti në 43.2 vjeç (nga 43.1 vjeç) ndërsa mediana nuk ndryshoi, ngeli 41.0 vjeç. Te femrat mesatarja u ngrit lehtë në 37.7 vjeç (nga 37.2 vjeç), ndërsa mediana ngeli e njëjtë, 35.0 vjeç.

MESATARJA FEMRA:

37.7



MEDIANA FEMRA:

35.0



Për këtë vit kemi një rritje të lehtë të kontribuuesve të grupmoshës 45+, arsyet e të cilës lëvizje mund të jenë edhe punësimet e stafit më në moshë nga organizatat private ose formalizimi më i madh i kësaj kategorie.

Tri grupmosht e tjera, në moshën 45 vjeçare, kishin një rënie të lehtë në pjesëmarrjen ndaj kontribuuesve

të angazhuar në ndonjë punësim formal gjatë vitit 2022.

Përgjithësisht për vitin 2022 kemi një rënie të numrit të kontribuuesve aktivë të moshës së re (deri 45 vjeç), që mund të jetë ndikuar nga disa faktorë, por një ndër ta mund të jetë edhe emigrimi, që mund të ketë sforcuar punëdhënësit për të rekrutuar staf në moshë më të shtyrë.

GRUPMOSHA	2022	2021
15-24	17.9%	18.1%
25-34	28.1%	28.7%
35-44	23.0%	22.7%
45-54	17.8%	17.6%
55-64	12.3%	12.0%
65+	0.8%	0.9%

KONTRIBUESIT SIPAS NDËRMARRJEVE

Lloji i ndërmarrjeve përcaktohet sipas regjistrimit të tyre në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare ose në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike.

Duhet theksuar se ndërmarrjet publike dhe shoqërore (të tilla si kompanitë rajonale të ujësjellësit ose mbeturinave, Posta e Kosovës, ngrohtoret e qytetit etj.) shumica e tyre janë të regjistruara si shoqëri aksionare. Prandaj paraqiten së bashku me ndërmarrjet e tjera publike, në kuadër të grupit të shoqërive aksionare.

Gjithashtu, numri i kontribuuesve sipas ndërmarrjeve nuk përputhet me numrin e kontribuuesve aktivë për vitin, për shkak se tek shifrat sipas ndërmarrjeve një kontribuues paraqitet më shumë sesa njëherë - nëse është i punësuar në dy a më shumë lloje ndërmarrjesh.

Në vitin 2022 rezultojnë se kishim të punësuar më pak në orgnizatrat buxhetore, krahasuar me vitin paraprak. Por kjo kishte ndodhur për shkak se më 2021 pagesat e ekzekutuara nga Ministria e Financave për rimëkëmbje nga pandemia, pagesat e bëra për si ndihmë qytetarëve

ishin paraqitur teknikisht si të angazhuar në organizatat buxhetore. Andaj me përfundimin e një sërë masash të tilla për rimëkëmbje ky numër ka ndryshuar. Ndërkohë sivjet rezultojnë të kishim ndjeshëm më shumë të punësuar në ndërmarrjet që operojnë si SHPK, ku edhe koeficienti i angazhimit është paksa më i lartë se vitin e shkuar. Në sektorët e tjerë nuk rezultojnë që kishte ndryshime të larta nga viti i shkuar.

Një rënie e lehtë vërehet tek bizneset individuale, ndërsa gati i pandryshuar është numri i të vetëpunësuarve. Tek shoqëritë aksionare kishte më shumë kontribuues aktivë por koeficienti i angazhimit është ulur. Tek OJQ-të kishim më pak të angazhuar sivjet por koeficienti i angazhimit është rritur. Ortakëritë pak u përmirësuan, me koeficient diçka më të lartë këtë vit.

Koeficienti më i lartë i angazhimit edhe këtë vit ishte tek organizatat buxhetore (prej 0.909) dukshëm më mirë sesa vitin e shkuar (për shkak të masave anti-covid). Pas tyre vinin shoqëritë aksionare (me 0.712), por paksa më dobët sesa më 2021.

LLOJI I NDËRMARRJES	2022			2021		
	KONTRIBUES NË NUMËR	KOEFICIENTI I ANGAZHIMIT	KONTRIBUES EKUIVALENTË	KONTRIBUES NË NUMËR	KOEFICIENTI I ANGAZHIMIT	KONTRIBUES EKUIVALENTË
Organizata buxhetore	93,898	0.909	85,353	132,438	0.675	89,396
SH.P.K.	251,729	0.664	167,148	216,890	0.601	130,351
Biznese individuale	72,805	0.666	48,488	74,262	0.653	48,493
Të vetëpunësuar	26,700	0.663	17,702	26,677	0.655	17,473
Shoqëri aksionare	33,835	0.712	24,091	28,293	0.748	21,163
OJQ	24,710	0.456	11,268	25,385	0.383	9,722
Ortakëri	3,374	0.635	2,142	3,230	0.649	2,096
Të tjera	10,577	0.635	6,716	16,259	0.452	7,349



KONTRIBUIMI MESATAR

Në tabelat në vijim prezantohen të dhënat për kontribumin mesatar mujor për tri vjetët e fundit e deri në fund të 2022-s. Të dhënat janë paraqitur sipas llojit të kontribimit, sipas grupmoshëgjinisë së kontribuuesve.

Përgjithësisht rezulton se kishim ngritje të vlerës së kontribimit mujor në secilën nga të dhënat e paraqitura.

Kjo mund të jetë si rezultat i ngritjes së të ardhurave nga pakot stimuluese dhe ngritjet e pagave (si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik) për

shkak të inflacionit të lartë në vitin e kaluar në Kosovë.

Rritja e kontribimit mesatar mujor është reflektuar te të gjitha grupmoshat për vitin 2022, porse më e larta ishte tek grupmosha 35-44 vjeç dhe ajo 45-54 vjeç.

Lëvizje pozitive vërehen edhe tek të punësuarit, për të gjitha grupmoshat.

Kundrejt tyre, ngritje më të ulëta kishim tek femrat dhe të vetëpunësuarit.

KONTRIBUIMI MESATAR MUJOR

VITI	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR
2020	€42.85	€32.04
2021	€45.32	€33.36
2022	€53.07	€35.08

KONTRIBUIMI MESATAR MUJOR SIPAS GRUPMOSHAVE

MOSHA	2022		2021		2020	
	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR
15-24	€35.50	€23.27	€29.75	€20.63	€27.62	€20.09
25-34	€50.75	€26.78	€42.68	€25.77	€38.57	€24.98
35-44	€60.08	€35.37	€51.82	€33.99	€47.86	€32.42
45-54	€60.10	€37.41	€53.12	€35.70	€49.02	€34.99
55-64	€61.14	€40.04	€56.37	€39.40	€54.58	€37.10
65+	€70.56	€44.08	€68.57	€40.33	€65.75	€40.31

KONTRIBUIMI MESATAR MUJOR SIPAS GJINISË

VITI	FEMRA		MESHKUJ	
	PUNËMARRËSE	TË VETËPUNËSUARA	PUNËMARRËS	TË VETËPUNËSUAR
2020	€40.07	€25.86	€44.41	€33.45
2021	€40.07	€25.86	€44.41	€33.45
2022	€46.87	€28.20	€57.17	€36.84

NIVELI I KONTRIBUIMIT

Legjislacioni aktual në fuqi kërkon që kontributi minimal për të vetëpunësuarit, si dhe të punësuarit me kohë të plotë, të bazohet në pagat minimale mujore të Kosovës, e që janë: €130 për personat e moshës deri 35 vjeç; dhe €170 për moshat mbi 35 vjeç.

Siç e kemi theksuar vazhdimisht, ky nivel i pagës minimale është shumë i ulët për të siguruar një bilanc të kursimeve pensionale që do të ofronte sigurinë e duhur pas kalimit në pension.

Përkundër se është nivel i ulët i kontribuit, ende numri i të punësuarve që deklarohen nën minimumin e kërkuar ligjor është duke ndodhur.

Ndërsa tek të punësuarit kemi përmirësim të kontribuit mbi minimumin ligjor, përkundër se sidomos për moshat në 35 vjeç gati 4% e kontribuuesve paguajnë kontribute nën minimum, më shqetësues është shkalla e pagesës së kontributeve për të vetëpunësuarit.

Rreth 41% e të vetëpunësuarve paguajnë kontribute vetëm sa minimumi (36.9% e tyre) ose nën minimumin ligjor (4.2% e tyre). Me këtë nivel të pagesës së kontributeve pensionale do të jetë shumë brengosëse periudha e jetës pas pensionimit. Mundësia që të pensionuarit e tillë të jenë barrë sociale është mjaft e lartë.

NIVELET E KONTRIBUIMIT TË PUNËMARRËSVE

	PAGESA		
	NËN MINIMUM	SA MINIMUMI	MBI MINIMUM
DERI 35 VJEÇ	3.75%	0.51%	48.16%
MBI 35 VJEÇ	0.87%	1.85%	46.58%

NIVELET E KONTRIBUIMIT TË TË VETËPUNËSUARVE

	PAGESA		
	NËN MINIMUM	SA MINIMUMI	MBI MINIMUM
DERI 35 VJEÇ	0.16%	2.42%	14.51%
MBI 35 VJEÇ	4.06%	34.48%	35.8%

“SA DUHET KURSYER?”

FKPK-ja e sheh si përgjegjësi të sajën, edhe sociale, që t'i këshillojë kontribuuesit se sa do të duhej të kursenin për të arritur një bilanc kursimi që do të mund t'iu ofronte më shumë siguri pas pensionimit.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë prej të dhënave nga ASK, del se personat që mbushin 65 vjet, jetojnë mesatarisht 78.5 vjet (77.6 meshkujt dhe 79.4 femrat). Pra, kjo është moshë mesatare e vdekjes për të gjithë ata që e i kanë mbushur 65 vjet që i përafrohet jetëgjatësisë aktuale të pritur. Në këtë rast do të nevojiten kursime pensionale për të financuar pension për 162 muaj.

Andaj në vijim prezantojmë disa këshilla e sugjerime që i vlerësojmë të rëndësishme.

Shembull: nën supozimin se çmimi i aksionit i FKPK-së do të rritet çdo muaj me një normë konstante prej 2.5% në vit (rritja mesatare që nga themelimi i FKPK-së), për një person që punësohet në ditëlindjen e tij të 25-të dhe që kontribuon (së paku) sa minimumi ligjor (aktualisht 13 euro) për 40 vjet deri në pensionim, do të ketë një bilanc të akumuluar në llogarinë e tij në FKPK prej €10,704.

Megjithatë inflacioni e gërryen fuqinë blerëse të parasë dhe ky inflacion mesatar ka qenë rreth 2% në vit (inflacioni mesatar që nga themelimi), vlera e sotme e këtij bilanci do të ishte rreth €6,900. Nëse ky bilanc do të përpjestohej për 162 muaj, shuma mujore për t'u shpëguar do të ishte €42.60. Nëse kësaj i shtohet edhe shuma prej €100 e pensionit bazik, një pensionist do të kishte në dispozicion vetëm €143 në muaj.

Në rrethanat aktuale një person i tillë do të pensionohej në programin e tërheqjes me fazë, me mundësi të tërheqjes në një pagesë fillestare të 20% të totalit të bilancit dhe tërheqjen e shumës së mbetur nga €200 në muaj do të mjaftonin për vetëm 34.5 muaj.

Në anën tjetër, nëse i njëjti person do të kontribuonte me kontributin mesatar (që për vitin 2022 që është €53.07) dhe duke i pasur parasysh parametrat e mësipërm, atëherë bilanci i përgjithshëm i kursimeve pensionale do të ishte rreth €28,200. Nëse ky bilanc do të përpjestohej për 162 muaj, shuma mujore që do të mund të përfitohej nga FKPK-ja do të ishte €174, ku së bashku me pensionin bazik prej €100 euro do të arrinte në €274. Edhe kjo shumë është mjaft e ulët për një pension, por sido që të jetë është substancialisht më e lartë se ai me kontribim minimal.

Arsyeja kryesore e shumës së ulët të kursimeve pensionale është norma e ulët e përqindjes së kontribuit. Në shumicën e skemave pensionale, ndahet së paku 20% e pagës bruto për kursime pensionale (ndërsa tek në kjo normë është 10%). Arsyeja e dytë është edhe norma e ulët e kthimit mesatar vjetor. Kjo për shkak se fondi është relativisht i ri dhe se në fillim ka qenë më i fokusuar në sigurinë e mjeteve dhe se kursimet e të gjitha grup-moshave kanë qenë të investuara në një portofol.

Nga shkurti i vitit 2022 janë dy portofole dhe me vonë planifikohet të shtohet edhe një portofol i ndërmjetëm, që do mundësojë që investimet të bëhen në bazë të grupmoshave. Portofoli i grup-moshave më të reja mund të investohet në mënyrë agresive më një tolerancë më të madhe të rrezikut dhe me një kthim potencial më të lartë.

Ndërsa portofoli i grup-moshave më afër pensionimit do të investohen në mënyrë më konservative, që t'i mbrojnë kursimet e akumuluar ndër vite.

06

LEGJISLACIONI

Korniza ligjore
Ndryshimet e propozuara

KORNIZA LIGJORE DHE NDRYSHIMET

Organizimi, funksionimi dhe vendimmarrja e FPKK-së bazohet në Ligjin Nr. 04/L-101, së bashku me plotësimet dhe ndryshimet me: Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin Nr. 04/L-168 dhe me Ligjin Nr. 05/L116, si dhe qeveriset nga Bordi Drejtues.

Organizimi ligjor i FPKK-së saktësohet tutje edhe me legjislacionin sekondar: përmes rregulloreve për pensione të BQK-së, dhe udhëzimeve e njoftimeve shpjeguese të ATK-së për mënyrën e deklarimit, kontribuimit, korigjimit dhe tatimit të kontributeve pensionale.

Në faqen vijuese kemi prezantuar propozimet tona për plotësime /ndryshime ligjore për çështjet më të rëndësishme aktuale në fushën e kursimeve të obligueshme pensionale.

PROPOZIME PËR PLOTËSIMET/NDRYSHIME LIGJORE

1. KUFIZIMET PËR INVESTIMET NË LETRAT ME VLERË TË QEVERISË SË KOSOVËS

Kufizimi aktual ligjor që deri 30% e mjeteve mund të investohen në fletobligacionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës mund të rritet në 50%, për të mundësuar më shumë investime në këtë instrument. Gjithashtu mund të rishikohet edhe kufizimi tjetër rregullues që përcakton se FPKK-ja mund të ofrojë maksimumi sa 50% e shumës së një ankandi të fletobligacioneve të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

2. PASQYRAT VJETORE TË LLOGARIVE

Legjislacioni kërkon që pjesëmarrësve t'iu dërgohet pasqyra vjetore me shkrim. Përderisa dërgesat me email janë mjaft të sigurt, ato me postë, edhe për shkak të mungesës së adresave të sakta, nuk e arrijnë personin e duhur. Falë edhe portalit eTrusti, dhe qasjes në të përmes eKosova, duhet të hiqet apo ndryshohet kjo kërkesë ligjore, meqë qasja në pasqyrë është e mundur në çdo kohë.

3. INVESTIMET NË "AKSIONE PRIVATE"

Është e nevojshme që FPKK-ja, sikurse shumë fonde pensionale në botën e zhvilluar, të lejohet të investojë përmes aset-menaxherëve në investime alternative të tilla si "Private Equity Funds" (fonde private të aksioneve). Investimet alternative mbulojnë klasa të ndryshme të mjeteve, siç janë kapitali privat, infrastruktura ose pasuritë e paluajtshme. Kjo do t'i shërbente diversifikimit, e ku alokimi do kufizohej mes 5% deri 10% të mjeteve.

4. HARMONIZIMI I SHPAGIMIT TË KURSIMEVE PENSIONALE DHE JETËGJATËSISË SË PRITUR

Për shkak se legjislacioni aktual nuk lejon që anuiteti nga shtylla e dytë të jetë më i ulët se pensioni minimal i dhënë nga shtylla e parë, shuma mujore që shpaguehet nga FPKK-ja harxhohet shumë shpejt. Po ashtu, meqenëse shtylla e dytë do të duhej ta financonte pjesën kryesore të pensionit, shuma e kursyer duhet të lidhet edhe me jetëgjatësinë e pritit. Për shkak se FPKK-ja akoma nuk e ka arritur maturinë e plotë (40 vjet), do të duhej të ndërlihej me përfitimet e shtyllës së parë, në mënyrë që të kemi pension të unifikuar. Psh. Të përpjestohet shuma e kursyer me vitet e jetëgjatësisë së pritit, atij bilanci t'i shtohet pensioni bazik dhe përfituesi të ketë një vlerë pensionimi të njëjtë gjatë tërë jetëgjatësisë së tij.

Në fillim kjo do të financohej në tërësi nga kursimet individuale në FPKK, ndërsa më vonë (kur këto mjete harxhohen), ky financim do të kalonte në buxhetin e shtetit. Pjesa që do të kursehej në fillim, do të shërbente që të financohej ky pension i kombinuar deri në fund të jetës së pensionistit. Pra, më këtë do të rrumbullakësohej edhe qëllimi i skemës pensionale, ku secili pensionist do ta merrte pensionin për tërë jetëgjatësinë e tij, në varësi të kontribuimit të tij. Përderisa tani marrin 20% të kursimeve si pagesë të menjëhershme dhe së paku €200 euro në muaj si dhe pensionin bazë, ky bilanc shteron vetëm për 4-5 vjetet e para. Më pas vlera e pensionit mujor bie drastikisht, duke u mbështetur vetëm në pensionin që financon nga Shtylla I.

5. TËRHEQJA E KURSIMEVE PENSIONALE PËR RASTE TË PAAFTËSISË PËR PUNË

Kjo mundësi ligjore duhet të modifikohet meqë tërheqja e mjeteve aktualisht po mundësohet edhe për personat të cilët ose janë ri-aftësuar ose edhe punojnë.

6. LLOGARITË JOAKTIVE

Duhet paraparë me ligj, se çfarë duhet bërë me llogaritë e kursimeve pasi që ato kanë pushuar së kontribuuari për një kohë të gjatë (p.sh. kur kontribuuesi arrin mbi 100 vjet dhe ende nuk i ka tërhequr mjetet vetë e as ndonjë trashëgimtar).

PËRGATITI

NJËSIA PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIK

AUTOR

JETON DEMI

E MIRATOI BOTIMIN

MENAXHMENTI I FKPK-SË

ADRESA

Rr. "Agim Ramadani" #182-184
10000 Prishtinë, Kosovë

E-MAIL DHE UEB

info@trusti.org
www.trusti.org



Fondi i Kursimeve Pensionale i
Kosovës